# UDHËZIM PËR ZBATIMIN E VLERËSIMIT GJATË SITUATAVE URGJENTE




Црвен крст на Република Македонија

ICRC

International Federation
of Red Cross and Red Crescent Societies

# Përmbajtje


## Shkurtesa dhe akronime

## 1. Për udhëzimin

1.1. Pse është e patjetërsueshme metodologjia për zbatimin e vlerësimit
1.2. Kush do ta përdorë këtë udhëzim
1.3. Si përdoret ky udhëzim

## 2. Koncepti i vlerësimit

2.1. Cikli projektues
2.2. Qëllimi i vlerësimit
2.3. Llojet e vlerësimit
2.3.1. Vlerësim i shpejtë
2.3.2. Vlerësim në detaje
2.3.3. Vlerësim i vazhdueshëm
2.3.4. Dallime mes tre llojeve të vlerësimit

## 3. Kornizë për mjerueshmëri dhe kapacitete

3.1. Vlerësimi i sektorëve prioritarë

## Pjesa 1: Procesi i vlerësimit

## 4. Hyrje

## 5. Para zbatimit të vizitës në teren

5.1. Revidim preliminar të informacioneve sekondare (të dorës së dytë)
5.2. A ka nevojë për vlerësim?
5.3. Përgatitja e vlerësimit
5.3.1. Definimi i qëllimeve dhe planit për punë
5.3.2. Vërtetimi i llojit të vlerësimit
5.3.3. Vërtetim se a do të bashkangjitet ndonjë partner në vlerësim
5.3.4. Zbatimi i revidimit detal të informacioneve sekondare
5.3.5. Definim se cilat informacione janë të nevojshme
5.3.6. Sjellje të vendimit se cila pjesë duhet të vizitohen dhe kush do të jetë popullata qëllimore
5.3.7. Organizim të grumbullimit të informacioneve
5.3.8. Organizim teknik të resurseve (resurse njerëzore, aranzhime logjike dhe vërtetim të kornizës kohore)

## 6. Gjatë vizitës në teren

6.1. Punë në teren: parime
6.2. Punë në teren: aktivitete
6.3. Si grumbullohen informacione
6.3.1. Vëzhgim
6.3.2. Intervista

## 7. Teknika të vlerësimit

7.1. Mjete participative
7.1.1. Kalendari ditor
7.1.2. Linjë historike kohore
7.1.3. Grumbullim proporcional të informacioneve
7.1.4. Kalendar sezonal
7.1.5. Rangim të çifteve
7.1.6. Analiza e participuesve
7.1.7. Dru “pse – pse”
7.1.8. Kapacitet i organizatave qytetare

## 8. Pas zbatimit të vizitës në teren

8.1. Analiza
8.1.1. Informacione ndryshuese
8.2. Grumbullimi i informacioneve
8.3. Sintetizimi i informacioneve
8.3.1. Hapi 1
8.3.2. Hapi 2
8.3.3. Hapi 3
8.4. Raport i vlerësimit
8.4.1. Analizë dhe mjete për lajmërim
8.4.1.1. Diagrami i interaksioneve
8.4.1.2. Analiza SWOT
8.4.1.3. Grafikone
8.4.1.4. Harta
8.4.1.5. Shëtitje për definim

# Pjesa 2: Përmbajtja e vlerësimit

## 9. Qasje ekonomike vendore

9.1. Definicion i ekonomisë vendore

9.2. Qasje ekonomike vendore
9.3. Hapa gjatë grumbullimit të të dhënave
9.4. Lista për kontrollimin e vlerësimit

**10. Elemente kyçe për të cilat duhet të kemi kujdes pasi të ndodhë katastrofa e shpejtë**


## Paraqitje


| | |
|---|---|
| Paraqitja 1 | Cikli projektues |
| Paraqitja 2 | Paraqitje me shemë të mjerueshmërisë dhe kapaciteteve |
| Paraqitja 3 | ___________________________ |
| Paraqitja 4 | Procesi dhe përmbajtja e vlerësimit |
| Paraqitja 5 | Procesi i vlerësimit |
| Paraqitja 6 | ___________________________ |
| Paraqitja 7 | ___________________________ |
| Paraqitja 8 | Shembull i orarit ditor të grave (Avganistan) |
| Paraqitja 9 | ___________________________ |
| Paraqitja10 | ___________________________ |
| Paraqitja11 | Shembull i kalendarit sezonal |
| Paraqitja12 | Renditja e çifteve – shembull i burimit të ushqimit |
| Paraqitja13 | Matricë për analizën e participuesve – shembull i GDF |
| Paraqitja14 | Dru “pse – pse” |
| Paraqitja15 | Diagrami i interaksioneve |
| Paraqitja16 | matrica e analizës SWOT – shembull i GDF |
| Paraqitja17 | Evaluimi i çmimeve në treg për misër në vitin 2000 |
| Paraqitja18 | Zona ekonomike të ushqimit |
| Paraqitja19 | Hartim i rreziqeve |
| Paraqitja20 | Hartim hapësinor |
| Paraqitja21 | Hartim hapësinor |
| Paraqitja22 | Shëtitje për definim – informacione të regjistruara |
| Paraqitja23 | Shëtitje për definim – diagram |
| Paraqitja24 | Proces analitik |


## Tabela


| | |
|---|---|
| Tabela 1 | ___________________________ |
| Tabela 2 | Përparësi dhe mangësi për të tre llojet e strukturës ekipore |

## Shukrtesa dhe akronime

**Sin]drom i hasur në mungesën e imunitetit**
AIDS acquired immunodeficiency syndrome
**Fodni Urgjent për Ndihmë gjatë Katastrofave**
DREF Disaster Relief Emergency Fund
**Njësia për Përgjigje gjatë Katastrofave**
DRU disaster response unit
**Qendra Operative për Vprim gjatë Situatës Urgjente**
EOC Emergency Operations Centre
**Njësia për Përgjigje gjatë Situatave Urgjente**
ERU Emergency Response Unit
**Mjete të pa eksploduara nga luftërat**
ERW explosive remnants of war
**Ekipi për Vlerësim dhe Koordinim**
FACT Field Assessment and Coordination Team
**Shpërndarje të përgjithshme të ushqimit**
GFD general food distribution
**Sistemi global për pozicionim**
GPS global positioning system
**Frekuenca e Lartë**
HF high frequency
**Virusi shkaktarë për mungesën e imunitetit tek njeriu**
HIV human immunodeficiency virus
**Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq**
ICRC International Committee of the Red Cross
**Person i Brendshëm i Shpërngulur**
IDP internally displaced person
**Strategji Ndërkombëtare për Uljen e Katastrofave**
ISDR International Strategy for Disaster Reduction
**Organizatë Joqeveritare**
NGO Non-governmental Organization
**Ekipë Rajonale për Veprim gjatë Katastrofave**
RDRT Regional Disaster Response Team
**Shërbimi për Projekte të Vogla**
SMS small message service
**Analiza SWOT, anët e fuqishme, dobësitë, mundësitë, kërcënimet**
SWOT strengths, weaknesses, opportunities and threats
**KB Kombet e Bashkuara**
UN United Nations
**UNICEF Fondi për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara**
UNICEF United Nations Children’s Fund
**Zhvillim Urgjent për Rehabilitim**
URD Urgence Réhabilitation Développement
**Vlerësim i Mjerueshmërisë dhe Kapaciteteve**
VCA Vulnerability and Capacity Assessment
**Frekuencë Shumë e Lartë**
VHF very high frequency
**Programi Botëror për Ushqim**
WFP World Food Programme

# 1. Për udhëzimin

## 1.1. Pse është e patjetërsueshme metodologjia për zbatimin e vlerësimit?

Vlerësimi është element vital i procesit të planifikimit të programeve. Siguron informacione në bazë të së cilës do të sjellen vendime të mëtutjeshme. Edhe pse informacionet e mira nuk garantojnë program të mirë, prapë se prapë informacionet e këqija pothuajse sigurisht garantojnë program të keq.

Përdorimi i metodologjisë standrade do të thotë se infromacionet të cilat janë marrë nëpërmjet vlerësimit do të mund të krahasohen me të dhënat të cilat janë të grumbulluara gjatë vlerësimeve të mëparshme.

## 1.2. Kush do ta përdorë këtë udhëzim?

Ky udhëzim është dizajnuar që ta përdorë secili që zbaton vlerësim, mes cilave:

- Të gjithë anëtarët e Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe;
- Secili i interesuar me njohuri të përgjithshme, për shkak se nuk nevojitet dituri e caktuar specifike teknike për ta përdorur atë.

**Person me njohuri të përgjithshme**

Personat me njohuri të përgjithshme janë njerëz pa fushë të caktuar të specializimit, për dallim të ingjinjerit për ujë dhe sanitacion apo nutricionistit.

Personi me njiohri të përgjithshme luan rol të rëndësishëm në zbatimin e vlerësimit, posaçërisht kur nevojitet analizë më e gjërë e përgjithshme të problemeve kryesore dhe ndikimit të cilin e shkaktojnë. Ekipi i personave të tillë që përdorin këtë udhëzim mund të ndahet dhe të mbulojë një fushë të madhe hapësinore për një periudhë të shkurtë kohore. Udhëzimi të ndihmojë anëtarët e ekipit që të grumbullojnë informacione për gjendjen e përgjithshme në sektorë kyç (shëndetësi, ujë dhe sanitacion etj.). Përdorimi i personave të tillë me njohuri të përgjithshmer do ta rrisë fleksibilitetin dhe do ta ulë periudhën e duhur kohore dhe çmimet e shpenzimeve. Por kjo nuk do të thotë se me këtë nuk ka nevojë për përdorimin e specialistëve. Rezultatet e vlerësimit të përgjithshëm do të sigurojnë bazë për dërgim të fokusuar të specialistëve sipas nevojës.

## 1.3. Si të përdoret udhëzimi?

Ky udhëzim siguron këshilla se të zbatohet vlerësimi. Lëvizja ndërkomëbtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe është involvuar në më shumë situata të ndryshme. Secili vlerësim është ndryshe, që është vetëm dëshmi që më shumë të ekzistojë llojsllojshmëri e madhe në proces. Ky udhëzime nuk e sqaron secilin aktivitet për secilin vlerësim. Megjithatë, udhëzimi siguron kornizë në të cilën duhet të organizohet vlerësimi. Me ndihmën e këtij udhëzimi, do të duhej

të keni mundësi t’i përfshini të gjitha aspektet kryesore të cilat janë të nevojshme për zbatimin e vlerësimit të suksesshëm.

Disa pjesë të udhëzimit do t’ju sjellin më shumë dobi për dallim prej të tjerave, varësisht nga situata me të cilën ballafaqoheni. Propozimet të cilat janë prezantuar këtu mund të adaptohen që të korrespondojnë në situatën tuaj specifike. Për këtë, mund të thuhet se ky udhëzim është dedikuar t’ju ndihmojë ta zbatoni në pajteushmëri me kontekstin e gjendjes urgjente me të cilën ballafaqoheni.

**Kaptinat prej 1 deri 3** përfshijnë koncepte të përgjithshme.

**Kaptinat prej 4 deri 8** (Pjesa 1) janë fokusuar në procesin e vlerësimit.
Rradhitja e kaptinave është pothuajse ekuivalent me rradhitjen e zbatimit të detyrave gjatë vlerësimit të vërtetë – planifikim, punë në teren, analizë dhe lajmërim. Megjithatë, vlerësimi nuk është proces linear dhe një pjesë më e madhe e këtyre detyrave përshtaten.

Pjesa 1 është adaptuar pjesërisht në pajtueshmëri me Udhëzimin për zbatimin e vlerësimeve urgjente të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (botimi i parë, tetor 2005).

**Kaptinat 9 dhe 10** (Pjesa 2) fokusohen në përmbajtjen e vlerësimit.

Pjesa 2 siguron kahje në bazë të elementeve të cilat duhet të merren parasysh me qëllim që më mirë të kuptohet natyra e situatës urgjente. Kjo njihet si “përmbajtje” e vlerësimit.

Komiteti ndërkomëbtar i Kryqit t kuq ka përgatitur rezime udhëzim për qasje ekonomike amvisërie. Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmnëhënës së kuqe siguron listë për kontrollim në bazë të punëve në të cilat duhet të ketë kujdes në dy periudha kohore specifike: 24 orë pas ndodhjes së katastrofës dhe 48 – 72 orë pas ndodhjes së katastrofës.

Fillimisht propozojmë që ta lexoni të gjithë dokumentin me qëllim që ta kuptoni strukturën dhe të njiheni me përmbajtjen e udhëzimit. Kur do të duhet ta përdorni dokumentin për zbatimin e vlerësimit të vërtetë, do të shihni se ka nevojë të shkoni mbarapa nëpër dokument me qëllim që të përshtateni në situatën e vërtetë në rastin tuaj.

## 2. Koncepti i vlerësimit

### 2.1. Cikli projektues

Cikli projektues përbëhet nga disa faza (shiko Paraqitjen 1) dhe ato faza në mënyrë gjenerale mund të përshkruhen në mënyrën që vijon:

- Vlerësimi: hasje të informacioneve për situatën me qëllim që të identifikohen problemet, burimi i problemeve dhe pasojat të cilat dalin nga ato;
- Planifikim/programim: organizim të aktiviteteve projektuese/programore;
- Implementim: aksione të cilat ndërmerren që të sigurohet përkrahja e popullatës;
- Monitorim: vëzhgim i vazhdueshëm dhe përcjellje e përarimit të realizuar nëpërmjet realizimit të projektit/programit;
- Revidim: kontrollim i përgjithshëm i përparimit t realizuar në bazë të realizimit të projektit / programit të zbatuar nga anëtari relevant i menaxhimit operativ;
- Evaluimi: kontrollimi i pavarur, objektiv dhe gjithëpërfshirës i politikës, programi, shërbimi për përkrahje apo operacioni për sigurimin e ndihmës së shpejtë, duke kyçur aspektin e dizajnimit, implementimit dhe ndikimit të realizuar.

**Paraqitja 1**

(SLIKA)

CIKLI PROJEKTUES / PROGRAMOR

PROCENA – VLERËSIM

PLANIRANJE PROGRAMIRANJE - PLANIFIKIM/PROGRAMIM

IMPLEMENTACIJA – IMPLEMENTIM

EVALUACIJA – EVALUIM

### 2.2. Qëllimi i vlerësimit

Qëllimi i vlerësimit është që të kuptohet situata e caktuar me qëllim që të identifikohet problem(e) i caktuar, burimi i problemit dhe pasojat e problemit.

Qëllimi i vlerësimit nuk është që të identifikohet intervenimi por të shqyrtohet se a ka nevojë për intervenim apo jo.

### 2.3. Llojet e vlerësimit

Ekzistojnë tre lloje të vlerësimit: vlerësim i shpejtë, vlerësim në detaje dhe vlerësim i vazhdueshëm (shiko tabela 1).

#### 2.3.1 Vlerësim i shpejtë

Zbatohet pas katastrofës së madhe siç është për shembull tërmeti apo shpërngulja e madhe e papritur e popullatës. Vlerësimi i shpejtë shërben për grumbullimin e informacioneve për nevojat dhe kapacitetet ekzistuese të popullatës së goditur, pjesët e mundshme të intervenimit dhe resurset e nevojshme. Vlerësimi i shpejtë zakonisht zgjatë deri në një javë. Pas kësaj vijon zbatimi i vlerësimit në detaje.

#### 2.3.2 Vlerësimi në detaje

Vlerësimi në detahje mund të zbatohet për shkak të shkaqeve në vijim:

- Është zbatuar vlerësim i shpejtë, por nevojiten informacione më detale me qëllim që të jepen rekomandimet e nevojshme;
- Lëvizja merr parasysh intervenimin në pjesë të re e për këtë nevojiten informacione detale për shkak të sjelljes së vendimit adekuat;
- Lëvizja dyshon se situata ndryshohet gradualisht (p.sh. vjen thatësirë e ngadalshme) dhe për këtë nevojiten më shumë informacione.

Vlerësimi detal në mënyrë gjenerale zgjatë rreth një muaj por mund të zgjasë më gjatë apo më shkurt varësisht nga madhësia e pjesës, kompleksiteti i problemit dhe resurset e kapshme.

#### 2.3.3 Vlerësim i vazhdueshëm

Vlerësimi i vazhdueshëm zbatohet pasi Lëvizja do të zbatojë vlerëim detal dhe është më operative në atë pjesë. Ky vlerësim nënkupton azhurim të rregullt të informacioneve në bazë të situatës, si dhe informacione reciproke nga përdoruesit me qëllim që të ndihmohet sjellja e vendimeve në bazë të ndërmarrjes së aktiviteteve afatgjate.

Vlerësimi i vazhdueshëm efektiv ndihmon që të detektohet ndodhja e ndryshimeve, e kur të ndodhë, që të inicohet vlerësim i shpejtë apo detal. Informacionet e grumbuluara gjatë vlerësimit t vazhdueshëm përdoren si *informacione sekondare* gjatë kohës së vlerësimit të shpejtë dhe atij detal.

**Tregues**

Tregues ësht njësia matëse kuantitative apo kualitative e cila duhet të sigurojë bazë të thjeshtë apo të sigurt për vlerësimin e përparimit, ndryshimit apo performansave të realizuara në punë. Përshembull, krahasim të çmimeve të prodhimeve elementare me çmimin ditor të punës mund të japë ide për trendin e varfërisë në pjesë të caktuar urbane.

Qasja me përdorimin e treguesve e ulë nevojën për intervista të gjata dhe rrezik nga marja e të dhënave të gabueshme. Megjithatë, treguesit janë të rëndë për definim dhe përdorimi i tyre i gabueshëm mundet në mënyrë të rrezikshme të shpie në drejtim të gabuar.

### 2.3.4 Dallime mes tre llojeve të vlerësimit

Të gjitha vlerësimet janë bazuar në procesin e njëjtë (identifikimi i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve) dhe të gjithë e përcjellin procesin e njëjtë (vëzhgim, intervistë, dhe grumbullim të informacioneve). Megjithatë, mënyra në të cilën grumbullohen informacionet varet nga lloji i vlerësimit.

- **Numri i lokacioneve të vizituara.** Gjatë vlerësimit të shpejtë krahasuar me numrin e lokacioneve të cilat vizitohen gjatë vlerësimit detal, prandaj është me rëndësi të zgjedhen mirë lokacionet të cilat do të vizitohen.
- **Numri i njerëzve të intervistuar.** Krahasuar me numrin e njerëzve të cilët intervistohen gjatë vlerësimit detal më pak njerëz intervistohen gjatë vlerësimit të shpejtë. Në këtë plan është shumë me rëndësi të konsultohen sa më shumë njerëz nëse ka mundësi.
- **Supozime.** Gjatë vlerësimit të shpejtë, koha e kaluar në teren është e shkurtë. Prandaj, në dise raste, duhet të mbështeteni në supozime. Supozimet bazohen në përvojat e mëparshme nga katastrofat e ngjajshme dhe njohuritë e mëparshme për pjesët e goditura. Gjatë vlerësimit detal apo të vazhdueshëm, më shumë kohë kalohet në teren dhe më pak ka nevojë që të mbështeteni në supozime.
- **Informacione sekondare.** Gjatë vlerësimit të shpejtë, ka më pak kohë për të grumbulluar informacione të dorës së parë, prandaj theksi vendoset në informacionet sekondare apo të dorës së dytë.

**Kuptimi i kontekstit**

Bile edhe tek vlerësimi i shpejtë, është shumë me rëndësi që të kuptohet konteksti, për shkak se mund të jetë me rëndësi për mirëqenien e poullatës së goditur. Përshembull, nevojat elemntare të personave të shpërngulur ndoshta janë të dukshme. Megjithatë në rrethana të caktuara, shpërndarja e gjërave (p.sh. materiale për strehim) mund ta rrezikojnë mirëqenien e përdoruesve, për shkak se këto materiale mund të tërheqin hajdutë.

| Karakteristika | Vlerësimi i shpejtë | Vlerësimi detal | Vlerësimi i vazhdueshëm |
|---|---|---|---|
| **Koha** | Rreth një javë | Rreth një muaj | Informacionet grumbullohen rregullisht gjatë gjithë periudhës operative |
| **Qasje në burime të informacioneve** | **Të kufizuar** Nuk ka kohë të vizitohen të gjithë lokacionet dhe të bisedohet me njeëz me burime të ndryshmetë informacioneve | Ka mundësi të vizitohen mjaft lokacione dhe të flitet me shumë njerëz me burime të ndryshme të informacioneve | Qasje të tërësishme |
| **Burime tipike të informacioneve** | Informacione sekondare, shërbime lokale (shëndetësi, furnizim me ujë etj) OJQ, institucione qeveritare, popullatë e goditur / nga vizita e shtëpive (shembull i vogël) | Informacione sekondare, spektër i gjërë i njerëzve me informacione | Informacione sekondare, zgjedhje e selktuar të njerëzve me informacione, tregues, të punësuar dhe vullnetarë të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. |
| **Rëndësia e supozimeve** | **E madhe** Kohë e pamjaftueshme të grumbullohen informacione. Bëhen supozime në bazë të përvojave të mëparshme. | **E vogël** Mjaft kohë për intervistim të spejktrit të gjërë të njerëzve me informacione. | **E mesme** Supozimet janë të bazuara në tregues dhe infromatorë, por ato mund të verifikohen edhe nga burime tjera. |
| **Lloji i ekipit për vlerësim** | Persona me përvojë në njohuri të përgjithshme, me përvoja paraprake për katastrofa të tilla. | Persona me njohuri të përgjithshme, por me përkrahje të mundshme të specialistëve nga fushat e ndryshme. | Të punësuar dhe vullnetarë të Kryqit t kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe të cilët zbatojnë aktivitete të rregullta. |

## 3. Kornizë për mjerueshmëri dhe kapacitete

Të gjitha vlerësimet bazohen në Kornizën për mjerueshmëri dhe kapacitete të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Ajo përbëhet nga analiza e problemeve dhe kapacitetit të njerëzve që të veprojnë për ato. Intervenimi i Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe ndoshta do të nevojitet nëse kapacitetet e njerëzve nuk janë të mjaftueshme të ballafaqohen me problemet. Procesi është i ilustruar në Paraqitjen 2.

**Paraqitja 2**




## Ранливост

Mjerueshmëria është e definuar si gjendje e cila është e renditur si rezultat i faktorëve apo proceseve fizike, sociale, ekonomike dhe politike të cilat e rrisin mjerueshmërinë e bashkësisë nga dikimi i shok-ut/rreziqeve.

Të gjithë njerëzit janë të mjeruar në diçka (p.sh. bujku varet nga shiu). *Mos nxjerrni supozime për mjerueshmëri të caktuar në bazë të përvojave nga vendet tjera.*

### Kapaciteti

Kapaciteti është definuar në mënyrën si në vijim: "Resurse të individëve, fqinjëve, bashkësive, institucioneve dhe vendeve për menaxhim me ndikim të një rreziku/kërcënimi të caktuar".

### Mekanizma për menaxhim

Mekanizmat për menaxhim janë strategjitë e pazakonshme të adaptuara të cilat i zgjedhin njerëzit si mënyrë e jetesës në kohëra të vështira të caktuara.

Mekanizmat për menaxhim mund të klasifikohen si:

- Strategji të cilat janë të dëmshme për pasurinë (dieta afatshkurte, grumbullim të pemëve të egra, shitje të pasurisë paesencë, migrimi ekonomik i individëve për shkak të punës, punësim plotësues, mjete solidare etj.) kompensohen dhe rregullohen lehtë.
- Strategji të cilat mund të jenë të dëmshme për pasurinë (p.sh. shitja e pasurisë, shitja e mjeteve për prodhim, prerje të mëdha të pyjeve, punësim të fëmijëve, prostituim, banditizëm). Janë të vështira për t'i rregulluar.

## 3.1 vlerësimi i sektorëve prioritar

Kur zbatohet vlerësimi, duhet tu jepet përparësi sektorëve në vijim:

- Ndihma humanitare
- Nevoja shëndetësore
- Pasuri
- Ujë, sanitacion dhe promovim të higjienës
- Ushqim dhe të ushqyerit
- Siguri dhe mbrojtje
- Strehim

**Paraqitja 3**




Rezultatet e vlerësimit  duhet ta përmirësojnë kualitetin e intervenimit.

Gjithashtu, është shumë me rëndësi të identifikohen kapacitetet e shoqatës nacionale dhe të shihet se cili është roli dhe mandati gjatë situatës në krizë. Kur grumbullohen këto informacione, duhet të merret parasysh plani për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente të shoqatës nacionale.

## 4. Hyrje

Në vlerësimin duhet të shikohet nga dy piëvështrime: si proces dhe përmbajtja e saj (shiko Paraqitjen 4). Kaptinat prej 4 deri 8 janë të fokusuara në proces.

Procesi i vlerësimit ka të bëjë me mënyrën në të cilën është zbatuar vlerësimi. Në të janë vërtetuar hapat e ndryshme apo metodat të cilat duhet të zbatohen me qëllim që të përmirësohet kualiteti në punë dhe të realizohen qëllimet e dëshiruara.

Ekzistojnë tre faza kryesore të procesit të vlerësimit:

- Para zbatimit të vizitës në teren;
- Gjatë vizitës në teren;
- Pasi të mbarojë vizita në teren.

**Paraqitja 4**




Edhe pse para se gjithash vlerësimi zbatohet në teren, puna e cila kryhet para dhe pas vizitës në teren është me rëndësi të njëjtë dhe ka ndikim të madh të kualitetit të përgjithshëm të vlerësimit.

Paraqitja 5 e ilustron procesin e vlerësimit. Merrni parasysh se aktivitete të caktuara nuk është patjetër të zhvillohen në drejtim linear. Për shembull, *analiza dhe revidimi i informacioneve sekondare* duhet të bëhen gjatë gjithë procesit.

**Paraqitja 5**


Процес на процена
Фаза 1 Пред спроведување на теренската посета
Прелиминарно ревидирање на секундарни информации (Види Дел 5.1)
Дали е потребна процена? (Види Дел 5.2)
Ако одговорот е негативен Тогаш работата е сработена
Ако одговорот е потврден, Подгответе ја процената
• Дефинирајте ги целите и планот за работа, (Види дел 5.3.1)
• Утврдете го видот на процена, (Види дел 5.3.2)
• Утврдете дали ќе се вклучи некој партнер во процената, (Види дел 5.3.3)
• Спроведете детално ревидирање на секундарни информации, (Види дел 5.3.4)
• Дефинирајте кои информации кои се потребни, (Види дел 5.3.5)
• Донесете одлука кои области треба да се посетат и која ќе биде целната популација (Види дел 5.3.6)
• Организација на собирање на информации (Види дел 5.3.7)
• Соберете ги потребните средства (човечки ресурси, логистички аранжмани и утврдување на временска рамка) (Види дел 5.3.8)
Фаза 2 За време на теренска посета
Набљудување (гледај, мирисај, слушај, чувствувај, допри) (Види дел 6.3.1)
Разговор со луѓето
• Интервјуа со информатори
• Индивидуални и групни интервјуа
• Структуирани и полуструктуирани или неструктуирани интервјуа (Види дел 6.3.2)
Фаза 3 По спроведувањето на теренска посета
Анализа на информации и одлука за препораки (Види дел 8.1)
Извештаи (Види дел 8.5)

## 5. Para zbatimit të vizitës në teren

Kjo pjesë do t'ju ndihmojë t'i sjellni vendimet fillestare:

- A ka nevojë për vlerësim?
- Cilat janë qëllimet e vlerësimit?
- Cili lloj i vlerësimit është adekuat?

### 5.1 Revidim preliminar i informacioneve sekondare

**Informacione sekondare**

Informacionet sekondare janë informacione të cilat tanimë janë të grumbulluara, ose nga ana e Lëvizjes ose nga organizata tjera. Informacionet sekondare mund të lidhen me ndonjë prej situatave të mëparshme apo me situatën momentale. Ato mund të jenë në formë të shkruar (raporte etj.) apo mund të jenë verbale sipas natyrës së vet (diskutime).

Bëni shqyrtim të shpejtë në informacionet sekondare që t'ju ndihmojë të vendosni se a nevojitet zbatim i vlerësimit. Kontrolloni raportet në media, kontaktoni përfaqësuesit e organizatave tjera humanitare dhe qeverisë; bisedoni me njerëz të cilët tani janë kthyer nga pjesa e goditur.

Definoni elementet në vijim:

- Natyrën e sinjaleve të cilat ju nxisin të mendoni se nevojitet vlerësim për zbatim;
- Situata urgjente;
- Informacione të cilat ju mungojnë.

### 5.2 A ka nevojë për vlerësim?

Mund të sjellni vendim për zbatimin e vlerësimit nga më shumë arsye, mes cilave janë:

- Ndodh shok i madh apo ndryshim i papritur (errupsion vullkanik, sulm i armatosur luftarak);
- Mendoni se në të ardhme të afërt mund të ndodhë situatë urgjente (jostabilitet i rrutr politik, thatësirë);
- Ju nevojiten më shumë informacione për situatën urgjente ekzistuese;
- Ju nevojiten më shumë informacione ta plotësoni udhëzimin;
- Arsye tjera.

Megjithatë mund të vini në përfundim se vlerësimi nuk është zgjedhje më adekuate për shkak se:

- Nuk është e mundshme qasje në pjesën e goditur;
- Informacionet ekzistuese (raporte të agjencive tjera etj.) janë të mjaftueshme;
- Shumë agjenci tanimë zbatojnë vlerësime në fushë të goditur, dhe mendoni se jeni në gjendje t'i mbulojnë nevojat adekuate dhe në mënyrë në kohë (pa u nxitur pritje të gabueshme bile as të zbatohen vlerësime të pa nevojshme;
- Është sjellë vendim të mos intervenohet.

**Ngopje nga vlerësime**

Mund të vjen deri në paraqitjen e ngopjes nga vlerësimet kur në fushë zbatohen shumë vlerësime nga agjenci të ndryshme. Njerëzit janë të frustruar për shkak se prej tyre kërkohet të përgjigjen në pyetje të njëjta përsëri dhe përsëri, shpesh herë pa rezultate të dukshme. Ato humbin durimin nga vlerësimet humanitare. Në rrethana të tilla mundësi është shumë e vogël që vlerësimi do të sigurojë informacione të dobishme.

### 5.3 Përgatitja e vlerësimit

Pasi të sillet vendim që të zbatohet vlerësim, ka gjëra të caktuara të cilat duhet të merren parasysh para se të bëhet vizita në teren.

#### 5.3.1 Definimi i qëllimeve dhe planit për punë

Shqyrtoni shkaqet për të cilat do të zbatohej vlerësimi. Definoni qëllimet e vlerësimit, pyetjet të cilat duhet të përgjigjen dhe aktivitetet të cilat duhet të përbëhet. Caktoni, sa më shumë që ka mundësi në detaje, çfarë kontributi të sigurojë ekipe për vlerësim. Jeni real. Caktoni vëllimin e informacioneve të cilat do të jenë të nevojshme për realizimin e qëllimeve të dëshiruara. Mendoni se kush do t'i përdorë informacionet dhe çfarë do të jenë nevojat e tyre. Njerëzit të cilët do t'i përdorin informacionet mund të jenë disa apo të gjithë që përmenden më poshtë:

- Të punësuarit në delegacionin e Federatës ndërkombëtare, në Sekretariatin e Federatës ndërkombëtare në Gjenevë apo të punësuar në qendrën e Komitetit ndërkomëbtarë të Kryqit të kuq;
- Donatorë;
- Përfaqësues të mediave apo persona të njësisë për komunikime;
- Lobues.

Nëse ka nevojël, përgatitni rregulla me të cilat do ta vërtetoni qartë se çka pritet nga ekipi i cili do ta zbatojë vlerësimin.

### 5.3.2. Vërtetim të llojit të vlerësimit

Vërtetoni se cilin lloj të vlerësimit do ta zbatoni: vlerësim të shpejtë, vlerësim detal apo vlerësim të vazhdueshëm (shiko Pjesa 2.3).

### 5.3.3 vërtetim se a do të kyçet ndonjë partner në vlerësim

Sillni vendim se a do ta zbatoni vetë vlerësimin apo në koordinim me partnerë të Lëvizjes së Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe apo partnerë të jashtëm (vlerësim të përbashkët).

#### Partnerë të brendshëm

Përdorni të gjitha resurset e mundshme të cilat janë të kapshme në kuadër të Lëvizjes. Nëse në vlerësim janë kyçur më shumë se një partner të Lëvizjes, shihni se çfarë kapacitete kanë dhe vërtetoni rolet e tyre. Rolet duhet të bazohen në:

- Mandatin specifik, specialitetet operative dhe rolet potenciale të secilit partner;
- Ligji dhe praktikat me të cilat rregullohet puna e shoqatës ancionale në vend;
- Kodi i sjelljes së Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe OJQ gjatë sigurimit të përkrahjes humanitare në kushte të katastrofave;
- Resurset njerëzore dhe operative;
- Kufizimet e partnerëve.

**Kujdes**

Nëse shoqata nacionale nga vendi i cili është goditur nga situatat urgjente nuk merr pjesë në vlerësim, rekomandohet që të punasuarit e saj të jenë të informuar për këtë para dhe pas zbatimit të vlerësimit.

#### Partnerë të jashtëm

Ka mundësi që të zbatohet vlerësim i përbashkët edhe me organizata tjera (qeveritare dhe / apo joqeveritare). Vlerësimi i përbashkët mund të jetë i dobishëm nga arsyet në vijim:

- Mund të rezultojë në bashkëpunim dhe koordinim gjatë planifikimit dhe implementimit të projekteve.

- Përdorim efektiv të resurseve (shpërndarje të resurseve njerëzore dhe logjistikë, dhe etj.), gjatë vlerësimit.
- Ulet mundësia për zbatimin e shumë vlerësimeve të ndryshme.

Ka shumë mënyra për shpërndarjen e përgjegjësive gjatë zbatimit të vlerësimit të përbashkët. Dy skenare të mundshme në këtë plan janë:

- Detyrat ndahen në pajtueshmëri me specializimin e secilit agjencion. Për shembull, Ekipi për vlerësim dhe koordinim në teren të Federatës ndërkombëtare mund të bëjë vlerësimin e furnizimit me ujë dhe qasjen në shërbimet shëndetësore, përderisa UNICEF mund të bëjë vlerësimin e nevojave për shkollim të fëmijëve të shpërngulur.
- Agjencitë me interese të ngjajshme kryejnë detyra të njëjta por në pjesë të ndryshme gjeografike. Për shembull, Komiteti ndërkomëbtar i Kryqit të kuq dhe Programit botëror për ushqim mund të bëjnë vlerësime për sigurinë e ushqimit në pjesë të ndryshme gjeografike të definuara paraprakisht.

Vlerësimi i përbashkët është i mundshëm nëse:

- Agjencitë – pjesëmarrëse ndajnë vlera dhe parime operative.
- Agjencitë – pjesëmarrëse ndajnë metodologji të njëjta apo kompatibile për zbatimin e vlerësimit.

Në rrethana të caktuara, vlerësimet e përbashkëta nuk janë adekuate. Për shembull:

- Nëse vlerësimet janë specifike në mandatin (p.sh. Komiteti ndërkomëbtar i Kryqit të kuq – punë mbrojtëse).
- Kur vlerat dhe parimet operative nuk janë kompatibile.
- Kur bashkëpunimi mund t'i dëmtojë parimet e neutralitetit dhe paanshmërisë.
- Kur organizatat dhe/apo individët perceptohen si të anojnë.

Kur ka mundësi, gjatë zbatimit të vlerësimit, duhet të bëhen marrëveshje formale ku do të specifikohen rolet dhe përgjegjësitë e secilës organizatë. Nëse zbatimi i vlerësimit të përbashkët nuk është i mundshëm, prapë se prapë me rëndësi është që të dihet se cilat organizata tjera zbatojnë vlerësime.

Vlerësime të sërishme në rajon të njëjtë janë kontraproduktive dhe joqefikase dhe ndikojnë në saktësinë dhe sigurinë. Revidimi i raporteve nga vlerësimet e organizatave tjera është komponentë esenciale e revidimit të informacioneve sekondare.

### 5.3.4 zbatimi i revidimit detal të informacioneve sekondare

Një prej detyrave të para të ekipit për vlerësim është revidmi detal i informacioneve sekondare. Atë bëjeni nëpërmjet kërkimit të të dhënave në vijim:

- Informacione elementare për pjesën për të cilën bëhet fjalë;
- Informacione të lidhura drejtëpërsëdrejti me çësthjet e theksuara në planin për punë;
- Informacione lidhur me arsyet dhe natyrën e ndryshimeve të afërta.

Informacionet sekondare ndihmojnë në formimin e idesë iniciale në bazë të problemeve të mundshme dhe është e dobishme gjatë planifikimit të intervistave të para në teren. Për shembull, përderisa në pjesë bujqësore e caktuar është goditur nga thatësirat, duhet të diskutohet me bujqit, mes tjerash, edhe për mbjelljen.

**Shembuj të informacioneve sekondare:**

- Raporte në teren nga vlerësimet e zbatuara nga Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe apo agjenci tjera.
- Raporte mediale.
- Studime sociale, ekonomike, politike dhe historike të bëra nga ana e qeverisë, universiteteve dhe grupeve vëzhguese.
- Anketa teknike nga ministritë qeveritare, universitetet, organizatat joqeveritare, agjencitë e Kombeve të bashkuara, vlerësimi i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve të zbatuar nga Kryqi i kuq dhe Gjysmnëhëna e kuqe.
- Të dhëna nga regjisatrimi të zbatuar nga qeveria.
- Të dhëna nga enti hidrometeorologjik.
- Harta.
- Deklarata nga dëshmitarë (njerëz të cilët tash kanë ardhur nga vendet e goditura).
- Komunikime verbale me ekspertë për pjesët e goditura apo për çështjet teknike relevante.

Ka shumë burime tjera. Në çdo situatë, merrni parasysh se cilat informacione mund t'ju shërbejnë dhe ku mund të gjenden këto informacione.

**Kritere për informacionet sekondare**

Nëpërmjet pytjeve të parashtruara më poshtë mund të vërtetoni se sa janë të sakta dhe të dobishme informacionet sekondare:

- Në cilën mënyrë janë grumbulluar informacionet: cila metodologji është përdorur në proces?
- Sa janë të sigurta burimet e informacioneve?
- Në cilën mënyrë informacionet mund të jenë të dobishme? (merrni parasysh natyrën dhe qëllimin për çka janë grumbulluar informacionet).
- Kur janë grumbulluar informacionet (a janë të vjetra)?
- A janë të bazuara informacionet në fakte apo në mendime?

Çdoherë shkruani burimet e informacioneve sekondare në raportin për vlerësimin e zbatuar

**Porosi kyçe**

Jeni të gatshëm në mënyrë kontradiktore ndaj ideve iniciale, dhe çdoherë priteni atë që nuk e keni pritur.

### 5.3.5 Definimi i informacioneve të cilat janë të nevojshme

Informacionet e nevojshme do të varen nga informacionet e sigurta të kapshme dhe qëllimet e vlerësimit. Për shembull, mos pyetni për shkallën e papunësisë nëse Ministria e punës dhe politikës sociale tani më siguron të dhënat të mira statistikore për këtë aspekt dhe mos i pyetni njerëzit në mjediset urbane për atë se sa janë të ardhurat e njerëzve nga të mbjellurat në mjediset rurale.

### 5.3.6 Sjellja e vendimeve se cilat pjesë duhet të vizitohen dhe cila do të jetë popullata qëllimore

Shpesh herë nuk ka mundësi të vizitohet i gjithë rajoni që është me interes. Prandaj patjetër të zgjedhen lokacione qëllimore si reprezentues për të gjithë territorin. Metodat statistikore për këtë qëllim zakonisht nuk janë të mundshme si rezultat i kufizimeve kohore dhe qasjes.

Prandaj duhet të përdorni revidimin e informacioneve sekondare që të identifikoni pjesë dhe grupe qëllimore të popullatës të cilët do të plotësojnë kriterin e përmendur më poshtë.

| | |
|---|---|
| **Prioriteti 1: Pjesa dhe / apo popullata të cilat janë të goditura drejtpërsëdrejti** | |
| ■ | Për shembull, zona ku ka ndodhur tërmeti, apo konflikti i armatosur, apo popullata e cila është shpërngulur me forcë nga vendbanimet e tyre. |
| **Prioriteti 2: Pjesët dhe / apo popullata të cilat janë goditur në mënyrë indirekte** | |
| ■ | Për shembull, pjesë të cilat janë goditur ekonomikisht nga konflikti i cili zhvillohet në rajonin fqinjë. |
| **Prioriteti 3: Pjesa dhe . apo popullata të cilat nuk janë goditur apo janë goditur shumë pak** | |
| ■ | Situata urgjente nuk ka ndikim të rëndësishëm në jetën dhe pasurinë e njerëzve (shumë e dobishme për krahasimin e pjesëve të goditura). |

**Paraqitja 6**




Gjatë vlerësimit të shpejtë, zakonisht ka kohë për vizitë të lokacioneve dhe popullatës në kategorinë me “Prioriteti 1”. Tek detajet dhe vlerësimet e vazhdueshme, duhet të vizitohen pjesë të selektuara nga tre kategoritë. Ndonjëherë është e pamundur të sigurohet qasje në pjesë të kategorisaë me “Prioriteti 1”. Nëse është rasti i tillë, mundohuni që të bisedoni me njerëzit të cilët kanë ardhur nga këto pjesë.

**Kujdes**

Sqaroni arsyet për zgjedhjen tuaj të pjesëve në raportin për vlerësim. Lista e pjesëve të cilat duhet të vizitohen mund ndryshohet pas vizitës së parë në teren.

Nëse, pas fillimit të punës në teren, bëhet e qartë se keni parashikuar pjesë të caktuara të rëndësishme, ato në mënyrë plotësuese mund të shtohen. Megjithatë, nëse keni afat të caktuar kohor, kjo do të thotë se pjesët tjera duhet hiqen nga lista.

### Metodat e zgjedhjes së shembullit për intervistim

Në mënyrë ideale, vendosni se cilën metodë të shembullit për intervistim do ta zgjedhni, para se të shkoni në teren. Përderisa ka nevojë, të njëjtën mund ta vendosni kur do të jeni në vendin e ngjarjes.

Nëse pjesët e zgjedhura janë të mëdha large, me shumë fshatra apo komuna (“lokacione”), ndoshta do të duhet të bëni nivel të dytë të selektimit. Keni dy opcione:

- **Zgjedhje e rastësishme e shembullit.** Këtë bëjeni kur lokacionet dhe pasuritë e shtëpive janë të ngjashme. Theksoni të gjitha lokacionet dhe në mënyrë të rastëisshme zgjedhni numrin të cilin do ta vizitoni.
- **Zgjedhje e shembullit.** Nëse lokacionet dhe/apo pasuria e amvisërive në mënyrë të rëndësishme dallohen, zgjedhni më shumë lokacione të ndryshme dhe/apo amvisëri të cilat do t’i paraqesin karakteristikat e ndryshme (etike, ekonomike, qytet / fashat etj.).

Në mënyrë gjenerale, më mirë është të vizitohen më shumë lokacione dhe të inrvistohen më pak njerëz në çdo lokacion se sa anasjelltas, të intervistohen më shumë njerëz në më pak lokacione.

**Kujdes**

Gjatë shumë situatave urgjente, formohen “qendra humanitare” rreth qyteteve kyçe. Organizatat fokusohen në këto lokacione dhe në mënyrë gjenerale mbulimi i nevojave për popullatën qëllimore janë të mira në këto rrethana. Megjithatë, shpesh herë ekzistojnë probleme dhe mungesa mes apo jashtë këtyre qendrave. Kur do të vendosni se cilat lokacione do t’i vizitoni, merrni parasysh se duhet të kyçni edhe disa nga këto pjesë.

**Shembull i zgjedhjes së rastësishme të amvisërive**

## Hapi 1. Vendosni se sa amvisëri do të intervistoni

Numri i amvisërive të intervistuara do të mvaret nga koha e kapshme dhe madhësia e bashkësisë. Zbatoni së paku tre intervista në secilin lokacion, por numri mund të jetë edhe më i madh nëse keni më shumë kohë. Ndani një orë për secilën intervistë, si dhe 30 minuta pauzë mes secilës intervistë.

## Hapi 2. Identifikimi i amvisërive të cilat do të intervistohen

Qëndroni në qendër të lokacionit. Rrotulloni ndonjë gjë apo hudhni stilograf në ajër që të shihni se në cilën anë do të bie. Shkoni në anën të cilën ua tregon sendi apo stilografi deri sa të arrni në fund të lokacionit, dhe gjatë udhës numëroni shtëpitë të cilat i kaloni. Ndajeni me numrin e amvisërive të cilat doni t'i intervistoni; në këtë mënyrë do të fitoni intervalin mes shtëpive (shiko Paraqitja 6):

- Dëshironi të intervistoni tre shtëpi.
- Shkoni në drejtimin i cili u paraqitet dhe numëroni 15 shtëpi gjatë rrugës.
- Intervali mes numrit të shtëpive del 15/2=5 (15 shtëpi të numëruara, 3 shtëpi të cilat do të jenë shembull për intervistim).
- Zgjedhni numër të rastësishëm mes një dhe pesë; kjo është amvisëria e parë të cilën do ta intervistoni.
- Pas kësaj shtëpie, shkoni në drejtimin e njëjtë dhe numëroni edhe pesë shtëpi; kjo është shtëpia e dytë të cilën do ta intervistoni.
- Krahasoni proceduraën e njëjtë që ta zgjedhni shtëpinë e tretë dhe të fundit.

**Paraqitja 7**




| Qasje alternative gjatë marrjes së shembullit të rastësishëm |
| --- |
| ■ Nëse shtëpitë janë pozicionuar në rrugë, zgjedhni rrugën dhe përcjelleni të njëjtën procedurë të përshkruar në Hapi 2.<br>■ Nëse ekzistojnë të dhëna të sakta për popullatën amvisëritë mund të zgjedhen sipas zgjedhjes së rastësishme me emrat e amvisërive. |

**Shembull i zgjedhjes me qëllim të amvisërive**

Përdoreni zgjedhjen me qëllim të shembullit nëse amvisëritë dallohen mjaft. Për shembull, ndoshta do të dëshironi të intervistoni amvisëri të caktuara për shkak se janë të margjinalizuara në mënyrë sociale apo kanë pasuri të cilat në mënyrë të posaçme dallohen nga të tjerat. Ka dy mënyra për marrjen e shembullit:

- Grupet janë të koncentruara në pjesë të caktuara të fshatit apo qytetit. Krahasoni zgjedhje të rastësishme të shembullit, siç është përshkruar më lartë, për secilën pjesë posaçërisht
- Amvisëritë janë të shpërndara nëpër të gjithë fshatin apo qytetin. Nëse mundeni t'i identifikoni amvisëritë për të cilat jeni të interesuar nga

regjistrimi i fshatit apo qytetit, zgjedhni numër adekuat sipas zgjedhjes së rastësishme nga regjistrimi. Nëse nuk ka të dhëna nga regjistrimi, kërkoni nga popullata lokale t'ju ndihmojë të identifikoni numër të duhur të amvisërive nga secili grup.

### 5.3.7 Organizim i grumbullimit të informacioneve

#### Lista iniciale për kontrollim

Ekipi për vlerësim e përpilon listën për kontrollim nga informacionet e duhura dhe burimet e mundshme para se të shkojë në teren. Kjo është pjesë e rëndësishme nga procesi i vlerësimit, për shkak se sigruon fikus për diskutim ekipor. Secilivlerësim obligon listë specifike për kontrollim.

Listat standarde për kontrollim nuk janë adekuate për shkak se:

- Secila situatëështëe ndryshme.
- Procesi i përpilimit të listës për kontrollim është me rëndsi esenciale.

Lista iniciale për kontrollim duhet t'i përmbajë elementet në vijim:

- Tema të cilat duhet të përfshihen:
- Metoda të cilat duhet të përdoren për grumbullimin e informacioneve;
- Njerëz me të cilat duhet të bisedohet dhe në cilën mënyrë të zbatohen intervistat;
- Lokacione të cilat duhet të vizitohen;
- Përgjegjësi për secilin anëtarë të ekipit.

Më shumë detaje në bazë të grumbullimit të informacioneve mund të gjeni në Pjesa 6.3.

**Porosi kyçe**

Listat për kontrollim nuk duhet të trajtohen si pyetësorë. Ato kanë për qëllim të ndihmojnë në memorimin. Gjatë intervistave, bëni listë për kontrollim që të shihni se a i keni mbuluar të gjitha.

Mbeteni të hapur për informacione të reja të cilat dalin nga intervistat. Sa më shumë përvojë që do të hasni, aq më pak do t'ju nevojitet lista për kontrollim.

### 5.3.8 Organizatë teknike të resurseve (resurse njerëzore, aranzhime logjistike dhe vërtetim të kornizës kohore)

#### Struktura e ekipit

Caktoni lider të ekipit (nëse nuk e keni bërë atë deri tani) dhe vendosni në bazë të strukturës së ekipit. Këtë mund ta bëni nëpërmjet njërës formë në vijim:

- **Personi(a) me dituri të përgjithshme:** një apo më shumë persona me përvojë **por pa njohuri të caktuara teknike**
- **Specialist (ë):** një apo më shumë persona të zgjedhur për shkak të përvojës apo aftësive të tyre;
- **Ekipë multi – diciplinues:** grupi i specialistëve dhe personave me njohuri të përgjithshme të cilët i prezantojnë të gjitha aspektet e punës së Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe (inxhinjerë, punëtorë shëndetësor etj.).

Përparësitë dhe mangësitë të scilës veprimtari janë paraqitur në Tabela 2

**Табела 2 Предностите и недостатоците на трите вида на структура на тим**

| Struktura ekipore | Përparësi | Mangësi |
|---|---|---|
| **Person(a) me dituri të përgjithshme** | Ekipi mundet shpejtë të mblidhet (për shkak se kërkohen specialistë me aftësi të posaçme). Kjo posaçërisht është e dobishme gjatë vlerësimeve të shpejta. | Mungesë e aftësive specifike do të thotë se nevojiten edhe vlerësime për përcjelljen e gjendjes kur do të identifikohen probleme teknike. |
| | Mund të sigurohe analizë e mirë gjithëpërfshirëse për situatën. | Problemet teknike mund të mos vërehen. |
| | Personeli i diciplinave të ndryshme mund ta zbatojë vlerësimin, prandaj përgjigjet për vlerësimin e vazhdueshëm. | Gjatë situatave ekstreme, ekipet për vlerësim suhet të sigurojnë përkrahje (p.sh. gjatë konfliktit). |
| **Specialist(ë)** | Mundet shpejtë të identifikojnë problemet në profesionin e tyre. | Mund të fokusohen shumë në profesionin e tyre dhe të gabojnë aspekte lidhur me kontekst më të gjërë. |
| **Ekipë multi diciplinuese** | Problemet teknike mund të kontrollohen në individë, e tejkalohet nevoja për vlerësim të | Janë të vështira për përshtatje me të gjithë profesionistët e duhur; prandaj vlerësimet nuk |

| | | |
|---|---|---|
| | vazhdueshëm. | janë të shpeshta. |
| | Përvojat e ndryshme sigurojnë bazë të gjëtë për analizë. | Ndoshta nuk nevojiten të gjithë specialistët teknik. |
| | | Ekipi është i vështirë për koordinim (metodologji jokompatibile, logjistikë e komplikuar). |
| | | Ekipet e mëdha janë kërcënim sigurie dhe mund të veprojnë në mënyrë trishtuese në bashkësitë e vogla. |

Zgjedheni strukturën adekuate të ekipit në bazë të rrethanave lokale me secilin vlerësim në mënyrë individuale, posaçërisht në bazë të llojit të informacioneve për të cilat keni vendosur t'i grumbulloni. Faktorë tjerë të cilat duhet të merren parasysh janë:

- **Gjuha:** Nëse ka mundësi, kyçni njerëz të cilët e flasin gjuhën lokale ku bëhet vlerësimi. Në seciliën ekipë le të ketë përkthyes aty ku ka nevojë.
- **Përfaqësimi gjinor:** Mundohuni që në ekipë të keni përafërsisht numër të njëjtë të meshkujve dhe femrave.
- **Përfaqësimi lokal:** Ndonjëherë është e dobishme që në ekipë të kyçni përfaqësues të popullatës lokale të cilët jetojnë në pjesën e goditur.
- **Anshmëri:** Të gjithë njerëzit në një farë mënyre janë që anojnë: perceptimet e tyre bazohen në prapavinë kulturore, përvojën trajnimin profesional dhe në shumë faktorë tjerë. Mundohuni të siguroni barazpeshë në bazë të pikëpamjes së anëtarëve individual të ekipit.

Kur ka mundësi, më mirë është të përdoret personeli i shoqatës nacionale apo i Federatës ndërkombëtare në pjesën ku do të bëhet vlerësimi në vend. Kjo do të thotë se vlerësimet mund të zbatohen shpesh, ulen shpenzimet rrugore dhe të tjera, dhe përforcohet lidhja mes vlerësimit, planifikimit projektues dhe implementimit.

**Porosia kyçe**

Kujdesuni që personeli të jetë dakord që t'i vizitoni lokacionet që keni zgjedhur. Për shembull, ndoshta ndonjëri prej njerëzve të grupit etnik nuk është i mirëseardhur në mjedisin e caktuar.

### Organizimi i udhëtimit në teren

Para se të shkohet në teren, lideri i ekipit duhet të kujdeset që të gjithë anëtarët e ekipit të jenë të informuar për gjërat në vijim:

- Planin për zbatimin e misionit dhe cilat janë pritjet nga vlerësimi;
- Planin ër aksion, duke kyçur metodologjinë e cila do të përdoret dhe korniza kohore;
- Marrëdhënie pune: përgjegjësitë e secilit anëtarë të ekipit, mënyra e dorëzimit të raporteve etj;
- Aranzhime politike për vlerësimin (transporti, vendqëndrimi etj)
- Pyetje sigurie, t.s.t situata momentale dhe procedurat të cilat duhet të përcjellen gjatë zbatimit të vlerësimit;
- Pyetje tjera relevante për vlerësimin në fjalë.

**Porosi kyçe**

Është shumë me rëndësi që të gjithë njerëzit të cilët janë të kyçur në vlerësim (duke i kyçur edhe përkthyesit) të marrin pjesë në organizimin e udhëtimit në teren.

Para se të niseni në teren, kujdesuni për gjërat në vijim:

- Koha e cila është në disponim (epriudhë kohore efektive e kaluar në teren) është e mjaftueshme që të realizohen qëllimet e planifikuara të vlerësimit.
- Periudha në vit është adekuate për zbatimin e vlerësimit.
- Në mënyrë adekuate janë organizuar të gjitha pyetjet logjistike dhe administrative lidhur me zbatimin e vlerësimit në teren.

## 6. Gjatë vizitës në teren

### 6.1 Puna në teren: parime

Parimet që vijojnë duhet të zbatohen gjatë zbatimit të punës në teren:

- **Konsultim me popullatën e goditur.** Të nxitet popullata e goditur nga situata urgjente se si shikon në situatë. Bile edhe tek situatat urgjente të cilat ndodhin shpejtë duhet që të kërkohet mendim nga popullata lokale.
- **Të merren parasyh nevojat e posaçme të grupeve dhe individëve të ndryshëm** (meshkuj, femra, persona të moshuar etj) Situatat urgjente kanë ndikim të ndryshëm në popullatën e goditur dhe nevojat e tyre do të dallohen.
- **Merreni parasysh sigurinë e informacioneve.** Informacionet mund të jenë të bazuara në “argumente” (përfundimisht të vërteta), mund të jenë të bazuara në “mendime” (të varura nga pikëvështrimi i personit i cili e

jep informacionin) apo të jenë “thashethëme” (të bazuara në informacione të pa vërtetuara)

- **Merrni parasysh anshmërinë.** Secili në një farë mënyre anon. Analiza e informacioneve duhet të marrë parasysh anshmërinë potenciale të informatorëve dhe të personave të cilët e zbatojnë vlerësimin.
- **Merrni parasysh interesat e grupeve të margjinalizuara.** Shihni se kush e ka forcën dhe zëri i cilit nuk mund të dëgjohet. Margjinalizimi mund të bazohet në gjini, përkatësi etnike, status social dhe/apo në shumë karakteristika tjera.
- **Keni kujdes në ndryshime dhe trende të cilat kanë ndikim në vijimet shoqërore.** Mundohuni të kuptoni se çka i nxit këto ndryshime.
- **Keni parasysh se mund të ndodhë e papritura.** Jeni të gatshëm që të ndodhë që supozimet e juaja të mos realizohen. Në shumë pjesë të botës ka ndikim trishtues social dhe ekonomik.
- **Merrni parasyh ndikimin e çështjeve të caktuara të shoqërisë në përgjithësi.** Për shembull, HIV/SIDA nuk është vetëm çështje shëndetësore.
- **Gjatë gjithë vlerësimit, mendoni se në cilën mënyrë do të përdoren informacionet.** Pyetuni se cili lloj i programeve do të ishte adekuat që tÇi përfshijë sfidat për të cilat diskutoni. Mendohuni se cilat efekte potenciale të programit do të ishin pozitive dhe negative.
- **Me kujdes dhe në kohë planifikoni vizitat në teren.** Mundohuni të tejkaloni situata kur njerëzit janë të zënë apo kur kanë festa dhe ahengje. Disa njerëz nuk janë të pranishëm gjatë ndonjë pjese të vitit ndërsa aktivitetet dhe gjendjet e mjeruara janë të ndryshme nga një kohë vjetore në tjetrën.

### 6.2 Puna në teren: aktivitete

Secila ditë në teren është e ndryshme dhe patjetër të planifikohet në mënyrë adekuate. Megjithatë, ekzistojnë hapa elementare të cilat duhet t’i përcjellë ekipi për vlerësim.

**Kujdes**

Hapat të cilat janë të përshkruara më poshtë nuk është patjetër të ndërmerren sipas renditjes së paraqitur. Disa mund të ndërmerren njëkohësisht nëse ekipi për vlerësim është mjaft i madh. Shpesh herë është patjetër të përsëriten disa prej hapave nëse hasim në parregullsi kontradiktore.

## Hapi 1. Çdo ditë planifikoeni me kujdes

Përgatituni për ditën tjetër (zakonisht bëjeni atë një natë më herët).

- Vendosni se cilat lokacione do t'i vizitoni;
- Bëni listën e informacioneve të cilat duhet t'i grumbulloni;
- Merruni vesh se si do t'i grumbulloni informacionet (këtëp mund ta ndryshoni gjatë ditës);
- Definoni përgjegjësitë (kush çka bën).

## Hapi 2. Realizoni kontakte me pushtetet lokale

Realizoni kontakte me pushtete lokale (dhe persona tjerë të interesuar) kur të arrini në vendin e duhur. Sqaroni se kush jeni ju, arsyen për vizitën dhe në ciën mënyrë do t'i grumbulloni informacionet. Ndonjëherë është mirë të keni përgatitur një rezime të shkurtë për organizatën tuaj për qëllimet e vlerësimit. Me këtë rritet transparenca dhe llogaridhënia para opinionit.

## Hapi 3. Përdorni teknikat për vëzhgim

Bëni një shëtitje joformale në pjesën së bashku me popullatën lokale. Në këtë mënyrë do të haseni me impresione fillestare për bashkësinë. Gjatë punës në teren, me kujdes vëzhgoni gjithëçka rreth jush (shiko Pjesa 6.3.1).

## Hapi 4. Intervista e njerëzve

Identifikoni grupe apo individë me të cilët do të bisedoni që t'i grumbulloni informacionet e duhura (shiko Pjesa 6.3.2).

## Hapi 5. Organizoni mbledhje me ekipin

Të gjithë anëtarët e ekipit për vlerësim duhet të mblidhen në periudha të caktuara kohore gjatë punës në teren. Kjo mund të jetë në mes dë ditës apo në fund të ditës. Në këtë mënyrë ato mund të japin ide dhe të meren vesh për ndryshime të caktuara nëse ka nevojë.

**Hapi 6. Takim në bashkësi në fund të vlerësimit**

Kur ka mundësi, duhet të mbahet takim me përfaqësuesit e bashkësisë pasi të mbarojë vlerësimi në teren. Sqaroni se çka është bërë, por mos premtoni asnjë ndihmë apo përkrahje.

## 6.3 Si grumbullohen informacionet

Informacionet grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit dhe intervistave.

### 6.3.1. Vëzhgim

Shpesh herë vëzhgimi si burim informativ lihet pas dore. Një numër mjaft i madh i informacioneve mund të grumbullohet edhe atë në mënyrë të shpejtë nëpërmjet vëzhgimit. Ajo që është edhe më e rëndësishme vëzhgimi mundëson të ndjehet situata dhe të merren impresione vizuele. Para se gjithash është edhe esenca e punës në teren. Principet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me vëzhgimin janë:

- Vlerësimi fillohet me shëtitje nëpër të gjithë lokacionin. Gjatë vlerësimit përdoreni mundësinë që të vëzhgoni sa më shumë që ka mundësi. Nëse diskutoni për ujë, kërkoni që t'i shihni burimet për furnizim me ujë. Nëse njerëzit ju flasin për ushqim të cilin nuk e njihni, provoni ta shihni dhe ta provoni. Mund të mësoni shumë nëse kaloni kohë në vende publike në bashkësi (kafiteri, çajtore etj.). Shikoni përreth dhe bisedoni me njerëz.
- Vëzhgimi është i dobishëm për kontrollim të thurrur të informacioneve. Për shembull, ju kanë treguar se shumë kafshë kanë pësuar gjatë thatësirave. Shumë shpejt pas kësaj shihni një kope me cjapë. Kjo nuk është patjetër të jetë në kontraditë me atë që ju kanë thënë – ekzistojnë shumë sqarime – por kjo mund të jetë bazë për pyetjet e juaja të tjera: "Të kujt janë këto kafshë?", e kështu me rradhë.
- Shëtitja nëpër këto pjesë e ndihmon edhe diskutimin me njerëzit. Atmosfera është joformale, dhe pyetjet dalin nga gjërat që punët të cilat i shihni. Kështu është më e natyrshme se sa të thirreni në listën e gjërave të cilat i keni shkruar në letër. Ajo që është shumë me rëndësi është që shkuarja dhe vëzhgimi janë mënyra të shkëlqyeshme që të arrihet në informacione të papritura.
- Vëzhgimi është mënyra më e mirë për vlerësimin e infrastrukturës dhe logjistikës. Me vozitje gjatë rrugës mund të shihni se a është rruga e kalueshme (por keni kujdes në pjesë në konflikt: minat dhe mjetet e pa shpërthyara nga konfliktet e luftës paraqesin problem serioz)
- Përfundimisht, një këshillë reale për të gjitha situatat: Thjeshtë bëhuni kureshtarë!

**Porosi kyçe**

Vëzhgimi nuk është vetëm shikim por gjithashtu edhe dëgjim, nuhatje, ndjenjë dhe prekje.

### 6.3.2 Intervista

Intervistat janë baza e vlerësimit në teren. Në secilën pjesë të informacionit të kërkuar duhet të shihen tre pika:

- Kush është (janë) person (a) më i (të) mirë me të cilin duhet të bisedohet në bazë të një informacioni të caktuar?
- A është mirë që me personin të bisedohet në mënyrë individuale apo në grupë?
- Cilat lloje dhe teknika të intervistimit duhet të përdoren?

**Zgjedhni se me kë do të bissedoni.**

Informatorët kyç janë njerëz të cilët kanë njohuri specifike për aspekte të caktuara në bashkësi. Ato janë burime të dobishme të informaccioneve në situata urgjente të cilat ndodhin menjëherë ku koha është e kufizuar. Shembuj tipik për këtë janë bujq, punëtorë shëndetësor, nëpunës qeveritar, anëtarë të shoqatave të grave, fëmijë dhe të rinjë, personeli i OJQ dhe tregtarë. Por secili me storje interesante mund të jetë i kyçur në listë. Keni kujdes me njerëz të tillë deri sa ta zbatoni vlerësimin.

Intervistat me informatorë kyç bazohen në dituritë dhe përvojat specifike të informatorit. Nëse personi i intervistuar është mjek, me siguri diskutimi do të jetë i forkusuar në çështjet shëndetësore. Megjithatë, keni kujdes në aspektet në vijim:

- Fakti që informatori është mjek (apo inxhinjer apo person me profesion tjetër) nuk do të thotë se ai/ajo i di të gjitha aspektet në temë; kirurgu i spitalit nuk është patjetër që të dijë shumë për çësthjet primare shëndetësore në pjesët rurale.
- Profesionistët, për shkak të pozitës së tyre së përgjithshme dhe kontaktet me profesionistë të tjerë, mund të kenë njohuri të mira për mjedisin politik dhe shoqëror dhe mund t'ju sigurojnë informacione të cilat janë jashtë punës së tyre.

Duhet të gjykoni me qëllim që të sjellni vendim se cilat informacione mund të jenë të dobishme nga informatorët. Filloni me intervistën me tema të përgjithshme, e pastaj vazhdoni kah temat specifike me interes.

## Vendosni se a do të zbatoni intervista në grupe apo individuale.

Intervistat mund të zbatohen në grupe apo me individë.

**Intervistat në grupe** mundësojnë interaksion mes njerëzve. Nëpërmjet nxitjes së atmosferës në debatë konstruktive, mund t'i kontrolloni informacionet dhe të kontrolloni gjëra rreth çështjeve të caktuara. Për shembull, dikush mund të thotë se problemet më serioze janë të lidhura me kualitetin e kushteve shëndetësore, por të tjerë mund të mos dakordohen me këtë. Vet debati, bile edhe nëse nuk mund të sjellni konkluza, mund t'ju japë ide për problemet e ndryshme të cilat kanë ndikim në bashkësi.

Intervistat në grupe janë të dobishme për dy qëllime:

- Të grumbullohen informacione për spektër të gjërë të temave. Të mblidhet grupë të profileve të ndryshme të njerëzve të cilët, së bashku, mund të japin pasqyrë të situatës.
- Të fitojë njohje më të mirë për çështje të caktuara (rezultate nga të korrat etj.). Në këtë rast, e dobishme është që të mbahet diskutim me grupë të njerëzve të profilit të njëjtë. Ky lloj i intervistës quhet "intervistë në fikus grupë".

Gjatë zbatimit të intervistave në grupe, të keni parasysh se:

- Disa njerëz janë më të sigurt në grupe për shkak të statusit të tyre në bashkësinë lokale. Njerëzit e grupeve të margjinalizuara ndoshta nuk do të dëshirojnë t'i shprehin haptazi qëndrimet e tyre, posaçërisht nëse pikëpamjet e tyre janë kontraverze.
- Nxitni atmosferë të relaksuar, jo formale; kërkoni që tëshprehen edhe ata të cilët nuk dëshirojnë të flasin shumë. "Ballafaqohuni" me ata të cilët janë shumë të bindur që të mos dominojnë vazhdimisht në diskutim.

**Kujdes**

Nëse mjedisi lokal është shumë hierarkik, ka kufi në bazë të llojllojshmërisë të cilën mund ta realizoni në grupë. Nëse nuk ka mundësi që njerëzit të flasin haptazi, apo nëse pjesëmarrja e tyre e lirë mund të nxisë probleme apo të tjerëve, më mirë të thirren grupe të posaçme ku statusi do të jetë më i balancuar (apo le të intervistohen në mënyrë të ndarë).

**Intervistat individuale** janë të dobishme për shkak të tre qëllimeve:

- Të merren informacione teknike nga njerëz të cilët paraqesin profesione të caktuara, si për shembull punëtorë shëndetësor apo persona nga fusha e furnizimit me ujë.
- Të haset dituri për gjendjen me kafshët dhe pasurinë e amvisërive.

- Të iniciohet diskutim në tema specifike të cila nuk janë adekuate për diskutimin në grupe (p.sh. dhuna seksuale tek popullata që ikin).
- Të kursehet kohë, kur nuk ka mjaft kohë për organizimin e intervistës në grupe.

**Kujdes**

Para se të zbatohet intervista individuale, keni kujdes që personi të mos vijë në situatë të padëshirueshme. Kur ka mundësi, sqaroni bashkësisë tjetër për çka dëshironi me atë person dhe cila është tema.

## Zgjidhni llojin e intervistës të cilën do ta realizoni.

Intervista mund të jetë gjysëm e strukturuar (me nënvizim të listës për kontrollim), e strukturuar (pyetësor) dhe jo e strukturuar (pa pika të përgatitura prej më herët). Rekomandohen intervistat gjysëm të strukturuara si mënyrë më e mirë për sigurimin e informacionit të mirë. Me ndihmën e pikave me nënvizim, do t'i mbuloni të gjitha pikat të cilat doni t'i pyetni, me mundësi që të jeni pak fleksibil që të lejoni diskutimi të zhvillohet në anë tjetër nëse ka nevojë për të.

### Intervista gjysëm e strukturuar

Intervista gjysëm e strukturuar është intervistë ku personi i cili e zbaton intervistën zgjedh disa çështje kyçe të cilat duhet të përfshihen por ngelet e hapur për tema tjera relevante të cilat mund të dalin në diskutim.

### Intervista e strukturuar

Intervistat e strukturuara dhe pyetësorët nuk janë të kyçur në këtë udhëzim për shkak se ato nuk janë shumë të dobishme për vlerësime të përgjithshme. Situatat shpesh herë janë të pa sigurta prandaj nevojitet proces fleksibil. Pyetësorët bazohen në pajisje fikse të definuara qysh para se të fillojë puna në teren: Ja edhe disa fakte në bazë të pyetësorëve:

- Përdorimi i pyetësorëve për kontrollimin e informacioneve komplekse dhe/apo të ndishme mund të rezultojë me informacione të cilat çojnë në drejtim të gabuar.
- Dizjanimi i pyetësorit të mirë obligon ekspertizë teknike, përvojë dhe kuptim të mirë të kontekstit.
- Pyetësorët mund t'i plotësojnë informacionet e fituara nga intervistat gjysëm të strukturuara dhe nga vëzhgimi (posaçërisht në pjesë teknike siç është uji dhe sanitacioni). Nëse ka nevojë të përdoret pyetësor ai duhet të përgatiet nga specialisti i sektorit relevant i cili e njeh mirë kontekstin specifik të situatës urgjente.

### Zgjedhni teknikë adekuate për intervistim.

Shumica e intervistave (në grupe dhe individuale) bazohen në kuadër për mjerueshmëri dhe kapacitete. Qëllimi juaj është që të kuptohen problemet me të cilat janë të ballafaquar njerëzit dhe mënyrat për menaxhim me ato probleme. Disa probleme janë të lehta për identifikim, për shembull shtpi të shkatërruara nga vërshimet; apo, keqpërdorimi i popullatës civile gjatë luftës. Këto çështje, nëse i shihni më thellë do të shihni se janë edhe më të komplikuara se sa në shikim të parë.

Kur zbatohet intervistë gjysëm e strukturuar, mundohuni t'i lëshoni personat e intervistuar. Shikoeni listën tuaj për kontrollim dhe kërkoni informacione plotësuese. Kontrolloeni pyetjen nga një këndvështrim tjetër me qëllim që në mënyrë tërthore t'i merrni informacionet e fituara.

Filloni me bisedë të përgjithshme për jetën në këtë pjesë dhe gjërat që i shihni rreth jush. Mos shkoni drejtë pyetje të drejtëpërdrejta për gjërat për shkak se:

- Me këtë jepni ton të gabuar në intervistë. Dëshironi të dëgjoni për aspektet pozitive si dhe negative të jetës në bashkësi.
- Koncentrimi në probleme jep përshtypjen se qëllimi juaj është që të zbulohet "çka mund të jep Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe". Kjo i nxit njerëzit ta prezantojnë "listën e dëshirave" në bazë të nevojave të tyre materiale.

Njerëzit patjetër do të fillojnë të flasin për problemet pa i obliguar ata. Kur do të ndodhë kjo, nxitni që t'ju sqarojnë problemet e tyre dhe si ballafaqohen me ato. Ndoshta nuk do të kenë dëshirë të flasin për të gjitha aspektet lidhur me mënyrën e tyre të ballafaqimit me probleme:

- Disa gjëra janë aq të integruara në mënyrën e vet të jetës sa që nuk e llogarisin për diçka shumë specifike për menaxhim me problemet. Për shembull, shpërndarja e resurseve mes familjeve të ndryshme.
- Komponente individuale për strategjitë e tyre për ballafaqim mund të japin kontribut të vogël prandaj njerëzit mendojnë se kjo nuk është aq me rëndësi të përmendet.
- Megjithatë, kut të gjitha komponentet e "vogla" do të shtohen së bashku, prapë se prapë japin kontribut të rëndësishëm në bazë të mirëqenies së familjes.
- Disa aktivitete mund të jenë jo legale, për shembull tregti e vogël pa leje apo grumbullim të hekurit të vjetër ku janë kyçur edhe mjete të pa eksploduara, dhe njerëzit nuk dëshirojnë t'ju flasin gjëra të tilla njerëzve të panjohur. As që do të shokjnë në detaje për aktivitete siç është prostitucioni, vjedhja apo shitja e gjërave të ndaluara.
- Njerëzit mundet edhe me qëllim të fshehin informacione me qëllim që situata e tyre të duket edhe më e keqe se sa është në realitet me qëllim që ta nxisin Kryqin e kuq / Gjysmëhënën e kuqe që t'ju ndihmojë.

Të gjitha këto probleme e theksojnë nevojën për qasje subtile. Pyetjet e drejtpërdrejta nuk janë adekuate. Në vend të kësaj, prekeni temën me kujdes me parashtrimin e pyetjeve në mënyra të ndryshme dhe keni kujdes në informacione të cilat mes veti vërtetohen apo janë kontradiktore.

Keni kujdes. Nëse njerëzve u vie keq të përgjigjen në ndonjë pyetje, mos insistoni.

## 7. Teknikat e vlerësimit

### 7.1 Mjete participuese

Në vazhdim janë paraqitur mjete apo teknika të cilat mund të zbatohen gjatë intervistimit që të nxitet interaksioni me personat të cilët sigurojnë informacione dhe të sqarohen informacionet të cilat ato i sigurojnë.

**Kujdes**

Këto mjete janë të dizajnuara që të përdoren me personat të cilët sigurojnë informacione që nuk janë mësuar në anketa analitike. Bëhuni diskret kur t'i përdorni këto mjete, ato nuk zbatohen në secilën situatë. Ngelet ekipi për vlerësim që të zgjedhë se cilat mjetedo t'i përdorë në situatën e dhënë.

#### 7.1.1 Kalendari ditorë

Kalendarët ditorë sigurojnë shqyrtim në bazë të asaj se si anëtarë të ndryshëm të bashkësisë e kalojnë kohën e tyre dhe si ndryshohet ky raport. Ata gjithashtu mund të ndihmojnë në zgjedhjen dhe dizajnin e programeve. Për shembull, nëse njerëzit kalojnë pesë orë në ditë duke bartë ujë, është mirë të merret parasysh që të inicohet projekt për përmirësimin e furnizimit me ujë.

Zbatimi i orareve momentale ditore me ato të mëparshmet ndihmon që të shihet se çfarë janë trendet. Për shembull, nëse njerëzit hecin dy orë që të sigurojnë drunj për nxemje, e më herët këtë e kanë bërë për gjysmë ore, mund të vihet në përfundim se ka problem të mungesës së pyjeve apo në pyje ka mina apo mjete të paeksploduara luftarake. Në këtë rast, mund të promovohet përdorimi i shporteëve efikas në kombinim me aktivitete tjera relevante.

- Shpesh herë është interesante të bëhen trajnime individuale me anëtarë të ndryshëm të familjeve (p.sh. fëmijë, burra dhe gra).
- Kërkoni nga pjesëmarrësit të përshkruajnë një ditë tipike, me paraqitjen e sa më shumë detajeve për aktivitetet e tyre dhe kohën e cila nevojitet për secilin prej tyre (shiko Paraqitja 8)

**Paraqitja 8**

## Shembull i kalendarit ditor i gruas në Afganistan

| | |
|---|---|
| **Lindja e diellit** | Zgjim.<br>Bartje të ujit.<br>Kujdes për fëmijë |
| **Në mëngjes** | Чистење на куќата.<br>Работа во кујната и дворот.<br>Одење на пазар да се купи храна. |
| **Në mesditë** | Përgatitja e drekës.<br>Burrat hanë drekë.<br>Gratë hanë drekë. |
| **Pasdite** | Larja e enëve.<br>Pastrimi i kuzhinës. |
| **Në mbrëmje** | Ndezja e zjarrit.<br>Ruajtja e fëmijëve.<br>Përgatitja e darkës. |
| **Në mbrëmje** | Shtrirja e fëmijëve.<br>Shtruarja e darkës për burrin.<br>Gratë hanë darkë.<br>Pastrim. |





### 7.1.2 Linja historike kohore

Qëllimi i linjës histroike kohore është që të kuptohet historia e tanishme në këtë fushë dhe banorët të cilët jetojnë në të në bazë të ngjarjeve kryesore që kanë pasur ndikime të caktuara pas mirëqenies së njerëzve.

Trajnimi mund të bëhet gjatë intervistës në grupe: sa është grupi i dallueshëm, aq do të jetë më i gjërë spektri i pikëpamjeve në bazë të historisë lokale.




- Tërhiqni një vijë dhe nënvizoni disa ngjarje që kanë ndodhur sipas tregimeve të njerëzve. Theksoni sipas renditjes kronologjike.
- Sqaroni se qëllimi është të plotësohen zbrazëtirat në këtë vijë me ngjarje tjera të tilla të cilat nuk janë të cekura.
- Kërkoni nga njerëzit të përkujtohen në ngjarje më të rëndësishme në të kaluarën (pozitive dhe negative) dhe kur kanë ndodhur ato në bazë të ngjarjeve tjera të cilat tani më janë të përmendura. Nxitni të sqarojnë arsyet dhe ndikimin e tyre.

### 7.1.3 Grumbullimi proporcional i informacioneve

Grumbullimi proporcional i informacioneve është ushtrim i dobishëm për llogaritjen e sasive dhe proporcioneve, posaçërisht kur punohet me njerëz të cilët nuk janë të mësuar të japin të dhëna kuantitative.

Për shembull, ndoshta do të duhet të dini raportin proporcional të bashkësisë sipas pesë grupeve të të hyrave të cilat i marrin familjet nga disa burime të ndryshme.

- Grumbulloni 100 kokrra groshe të thata (duhet të jenë me madhësi përafërsisht të njëjtë).
- Sqaroni qëllimin e trajnimit. Për shembull, kërkoni nga anëtarët e amvisërive ta përshkruajnë secilin burim të të hyrave.
- Kërkoni nga ata t'i ndajnë kokrrat sipas rëndësisë së burimit të të hyrave (shiko Paraqitja 10).

Përskaj asaj që është mjet për paraqitjen e të dhënave kuantitative, grumbullimi proporcional i informacioneve është mjet i mirë për facilitim. Gjatë punës në grupe, aktivitetet e tilla i shkatërron barrierat mes njerëzve. Kjo mund të shërbejë si mjet fokusimi për diskutim.

Zakonisht zhvillohet mjaft diskutim rreth madhësisë të secilit grumbull, dhe pastaj nxit pjesëmarrje dhe e rrit saktësinë gjatë llogaritjes së të dhënave dhe informacioneve.

**Paraqitja 10**




**7.1.4 Kalendari sezonal**

Kalendarët sezonal janë mjet i dobishëm për zbatimin në mjedise rurale ku prodhimtaria lëvizë gjatë vitit. Këto kalendarë mund t'i reflektojnë të gjitha ngjarjet më të rëndësishme që ndodhin gjatë vitit.

Kalendarët sezonal më së miri është që të definohen për periudhën prej tetëmbëdhjetë muajve, me qëllim që të paraqiten periudhat e kalimit prej një stine në stinë tjetër.

Dizajnimi i kalendarit zakonisht bazohet në bazë të vitit normal, me qëllim që të lehtësohen dhe ulen parregulsitë gjatë vlerësimit. Pa dallim se cila qasje do të zigjidhet në fund, kalendarët sezonal patjetër duhet të kenë vitin referues.

Më së mirë është që kalendarët sezonal të bëhen në atë mënyrë që do të fillojnë në ndonjë periudhë të rëndësishme të vitit (në vend të, për shembull, më

1 janar). Kalendari sezonal duhet të përmbajnë një kolonë për secilin prej këtyre dy elementeve:

- Muaj;
- Emra lokal të kohëve vjetore dhe rëndësia e tyre në bazë të aktiviteteve dhe prodhimtarisë;
- Pasqyrime klimatike (kryesisht të rreshurat);
- Praktika për ruajtjen e bagëtive;
  - Migracione të bagëtive sipas llojit;
  - Sezona të shumimit sipas llojit;
  - Sezona të lindjes sipas llojit;
- Prodhimi i kafshëve:
  - Prodhimi i qumshtit;
  - Prodhimi i mishit;
  - Prodhimi i prodhimeve të leshit;
  - Shitja e kafshëve;
- Prodhimi i bimëve dhe kulturave bujqësore (detalisht sipas llojit të prodhimit dhe përdorimit të tij, p.sh. shitja, ushqim për kafshë, ushqim për në shëtpi etj.):
  - Përgatitja e tokës dhe lëvrimi;
  - Mbjellja dhe korrja sipas kulturës bujqësore;
  - плевење;
  - kontrollimi nga parazitët dhe dëmtuesit;
  - shitja e tepricës së prodhimeve / blerja e ushqimit shtesë;
  - variacione sezonale të çmimeve në treg;
- kalendari i aktiviteteve për prodhim sekondar sipas: llojit, lokacionit, operatorit dhe kontributit të ekonomisë së amvisërisë;
- vëllimi i duhur i punës dhe shpërndarja e punës:
  - gra;
  - burra;
  - fëmijë;
- probleme:
  - sezona e urisë;
  - periudha e kalimit;
  - mungesë e ujit.

Paraqitja 11 paraqet shembull të kalendarit sezonal më të thjeshtë të kufizuar në 12 muaj që të lehtësohet ilustrimi.

**Приказ 11 Пример на сезонски календар**

| Siguri | J | Sh | M | P | M | Q | K | G | Sh | T | N | Dh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Të hyra të ulta | X | | X | | | | X | X | | X | | |
| Të hyra të larta | | | | | | | | | | | | |
| Emigrim dhe migrim | | X | X | X | | | | X | X | | | |
| Vjedhje | | | | | | | | | | | | |
| Sezona e mbjelljes së kulturave bujqësore | | | X | X | | | | X | X | X | | |
| Tregti me drogë | | | X | | | X | X | | | | X | |
| Aksidente trafiku | | | | | X | | | | | X | | |
| Dhunë familjare | X | X | X | X | | | | | X | X | X | X |
| Sezoni i korrjes | | | | | | X | | | | | | |
| Sezoni i shiut | | X | X | | | X | | | | X | X | |
| **Shëndet** | **J** | **Sh** | **M** | **P** | **M** | **Q** | **K** | **G** | **Sh** | **T** | **N** | **Dh** |
| Grip, ftohje | X | X | X | | | | | | | | X | X |
| Sëmundje të barkut, vjellje, diare | | X | | | | X | X | X | | | | |
| Konjuktivis | X | X | | | | | | | | X | | X |
| Sëmundje të cilat barten me ujë | | | | X | X | X | X | X | X | | | |
| Morra | X | X | | | | | | | | | X | X |
| **Rreziqe** | **J** | **Sh** | **M** | **P** | **M** | **Q** | **K** | **G** | **Sh** | **T** | **N** | **Dh** |
| Uragane | X | | | | | X | X | | | | | |
| Zjarre në pyell | | | | | | X | X | X | X | | | |
| Zjarre të kulturave bujqësore | | | | | | X | X | X | X | | | |
| Vërshime | X | X | X | X | | | | | | X | X | |
| Thatësira | | | | | | | | | | | | |
| Temperatura të ulta / të larta | X | | | | X | X | X | | | | X | X |

### 7.1.5 Rangimi në çifte

Rangimi në çifte është metodë participative që përdoret për definimin e prioriteteve që të përcaktohet rëndësi e caktuar relative. Për shembull, nga disa sigurues të informacioneve mund të kërkohet t'i tregojnë problemet apo nevojat e veta sipas rëndësisë prioritare e pastaj ekipi për vlerësim mund t'i kontrollojë përgjigjet.

Gjithashtu, mund të definohen dhe përshkruhen kategoritë ekonomike statusore në bazë të mjeteve dhe profesionit dhe mund të vërtetohen dallimet mes familjeve të varfëra, të mesme dhe të pasura. Pastaj rangimi në çifte në çifte mund të përdoret për vërtetimin e përkatësisë proporcionale sipas mirëqenies së grupeve popullore.

Rangimi në çifte gjithashtu është metodë shumë e dobishme për definimin e preferencës sipas renditjes së rëndësisë. Për shembull, që të vërtetohet rëndësia e burimeve të ushqimit, nga informatorët kërkohet t'i theksojnë burimet e ndryshme të ushqimit në të cilat ato mbështeten.

Pastaj, këto çështje të ndryshme, futen në rradhë dhe kolona: titulli në kolonën 1 është i njëjtë me atë të rendit 1, në kolonën 2 është e njëjtë me rendin 2 e kështu me rradhë. Pastaj gjërat një herë krahasohen me tjetrën, dhe nga informatorët kërkohet të përmenden; për shembull, "A preferoni punën 1 apo punën 2" apo " Cila është më me rëndësi: burimi 1 apo burimi 2?". Pastaj përgjigjet futen në katrorin adekuat. Puna, apo burimi i cili është zgjedhur më shpesh është më i rëndësishëm (gjegjësisht me prioritetin më të lartë); në këtë mënyrë rangohen të gjitha pyetjet apo burimet sipas renditjes së rëndësisë / domethënies (shiko Paraqitja 12).

**Paraqitja 12 Rangimi në çifte – shembull i burimit të ushqimit**

| Burimi i ushqimit | Prodhimi | Blerje | Grumbullim | Dhuratë |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi | | Prodhimi | Prodhimi | Prodhimi |
| Blerje | | | Grumbullim | Blerje |
| Grumbullim | | | | Grumbullim |
| Dhuratë | | | | |

Në shembullin në Paraqitjen 12, rezultatet janë:

- prodhimi theksohet si i rëndësishëm tre herë: 3.
- Grumbillimi theksohet si i rëndësishëm dy herë: 2.
- Blerja theksohet si e rëndësishme një herë: 1.
- Dhurimi asnjëherë nuk theksohet si burim më i rëndësishëm nga tjetri.

Me fjalë tjera, burimi më i rëndësishëm i ushqimit sipas mendimit të grupit është qartë prodhimi personal i njerëzve, përcjellur nga grumbullimi apo blerja e ushqimit. Ky grup duket se shumë pak mbështetet në fitimin e dhuratave.

### 7.1.6 Analiza e participuesve

Metoda në vijim është adaptuar sipas Serge Ghinet,1997.

Aksioni humanitar evolvon në kontekste të ndryshme në bazë të mjerueshmërisë në kriza, dimensionet sociale dhe funksionale, dhe interesat dhe punët e ndryshme që janë në fjalë. Nëpërmjet shqyrtimit të këtyre faktorëve të ndryshëm, ka mundësi të identifikohen participues të ndryshëm në mjedis të caktuar.

Qëllimi i përgjithshëm i analizës së participuesve është të sigurojë se operacioni zhvillohet në kushte sa më mirë që mundet. Prandaj, duhet të identifikohen interesat, aktivitetet dhe nevojat e participuesve në dialog me ata, me qëllim që të arrihet marrëveshje reciproke e pranueshme.

Në nivel praktik, këtu nënkuptojmë:

- Identifikim i njerëzve dhe grupeve të goditura në mjedis specifik;
- Definim në bazë të asaj, kush, çka, ku, kur, si dhe pse bën;
- Identifikim i interesave individuale;
- Kuptim të marëdhënies së fuqive
- Definim të nevojave për ndihmë;
- Kuptim të anëve dhe mundësive operative të fuqishme.

Participuesit mund të jenë:

- Individë;
- Grupet e interesuara;
- Pushtetet lokale;
- Shërbimet.

Participuesit identifikohen sipas kritereve të ndryshme:

- Karakteristikat e tyre:
    - Status social (pozita e tyre në strukturën shoqërore);

- Identitet (imazhi i tyre në sistemin për komunikim dhe këmbim);
- Projekt (qëllimi i determinuar nga rrethanat dhe resurset e kapshme);
- Fuqi (aftësia e tyre të ndikojnë në participuesit tjerë);

- Funksioni dhe roli i në sistemin shoqëror;
- Interesat e tyre;
- Gjërat që janë në fjalë që dalin nga ngjarjet specifike, posaçërisht aktivitetet në planin humanitar.

Analiza e participuesve zbatohet për secilin parametër të lartëpërmendur, sipas analizës. Participuesit janë të rregulluara në kolona ndërsa pyetjet në rradhë. Paraqitja 13 tregon shembull të analizës së participuesve lidhur me shpërndarje të përgjithshme të ushqimit.

**Paraqitja 13 Matricë për analizë të participientëve – shembull për shpërndarjen e përgjithshme të ushqimit (SHPU)**

| Pyetje | Persona të shpërngulur | Shitore për bujqësi | Tregtarë | Pushtete | Sigurim |
|---|---|---|---|---|---|
| Kyçje në SHPU | Po (janë të uritur) | Jo | Po (të kontrollohet) | Po (që të tregohet vullnet i mirë) | Po (që të shiten) |
| Sigurim të SHPU | Po | Varet nga periudha dhe korrja | Jo (nëse nuk mund ta kontrollojnë) | Po | Po |
| Ndalim të SHPU | Jo | Varet nga periudha dhe korrja | Po (nëse nuk munden ta kontrollojnë) | Po (nëse tregtarët i paguajnë mirë) | Po (nëse tregtarët i paguajnë mirë) |
| Shmangie të efekteve negative anësore | Po (nëse kjo siguron vazhdimësi të SHPU | Po | Po (SHPU mund të nxisë ulje të çmimit të prodhimeve elementare | Po (që të tejkalohen çrregullime dhe shtypje) | Varet se si efektet anësore ndikojnë në rolin dhe ndikimin e tyre |

Matrica e lartëpërmendur e thjeshtësuar nuk përmban participientë të rradhës së organizatave humanitare që janë kyçur në shpërndarjen e përgjithshme të ushqimit, por as donatorë, dhe palë të treta që e përkahin luftën.

Participientët patjetër të analizohen në këtë shembull në pajtueshmëri me mënyrën e tyre relevante në bazë të shpërndarjes së përgjithshme të ushqimit: patjetër të ndërmerren bisedime të patjetërsueshme me qëllim që të sigurohet shpërndarje pa pengesë të ndihmës së planifikuar në ushqim, gjegjësisht, pranueshmëria nga ana e participientëve në proces. Këtu përsëri, dialogu participues është qasje e vetme e mundshme.

### 7.1.7 Dru "pse – pse"

Dru "pse – pse" mundëson debatë participative në bazë të detektimit të arsyeve për problem të caktuar. Gjithashtu mundëson vërtetimin e prioriteteve në bazë të shkaktraëve të problemeve. Thjeshtë i ilustron marrëdhëniet mes shkakut dhe efektit. Nëpërmjet hyrjes në thelbin e çështjes, ky mjet mundëson definim më të mirë të qëllimeve dhe zgjedhje të strategjive adekuate intervenuese.

Paraqitja 14 paraqet shembull të drurit "pse – pse" në kontekst ku problemi kryesor është mungesa e ushqimit. Nëpërmjet përcjelljes së arsyeve të vërteta për mungesën e ushqimit, është e qartë se, shpërndarja e farës, për shembull, do të ishte zgjedhje adekuate, pa dallim se çfarë mendime tjera ka pasur për këtë çështje më parë.

**Paraqitja 14**




### 7.1.8 Kapacitetet e organizatave qytetare

Ky është mjet për analizë organizative. Mund të ndihmojë që bashkësia t'i identifikojë organizatat qytetare që janë të rëndësishme në bazë të funksionimit të tij. Organizatat qytetare mund të jenë nga rradhët e institucioneve fetare, shkollave, komiteteve financiare, spitaleve, trupave koordinues dhe pushteteve lokale.

Është e dobishme të:

- Identifikohen lloje të ndryshme të përkrahjes të kapshme për njerëzit, të cilat gradualisht mund të ndihmojnë të mbindërtohen kapacitetet lokale;
- Vërtetojë llojin e përkrahjes organizative e cila u duhet organizatave qytetare me qëllim që të adresohen problemet dhe rreziqet dhe të mbindërtohen kapacitetet menaxhuese.

Zbatoni intervista gjysëm strukturore. Temat për diskutim le të jenë si në vijim:

- Historia e organizatës qytetare.
- Kur dhe pse është formuar.
- Numri i anëtarëve aktiv dhe pasiv.
- Trende në bazë të anëtarësisë (numri rritet apo ulet?).
- Prezantim në mbledhje.
- Procese të sjelljes së vendimeve.
- Funksionim të komisioneve?
- A ka organizata plan zhvillimor për bashkësinë?
- Si është kontributi i grupit ndaj bashkësisë deri tani?

## 8. Pas zbatimit të vizitës në teren

### 8.1 Analizë

Analiza është proces i sintetizimit të informacioneve nga burime të ndryshme që ju mundëson të jepni përgjigje në pyetjet që vijojnë:

- Cilat janë problemet kryesore?
- Kë e godasin këto probleme?
- Cilat janë kapacitetet e popullatës së goditur? Sa mirë mund të ballafaqohen me këto probleme?
- A ka për momentin ndonjë ndihmë për popullatën e goditur?
- A ka nevojë për intervenimin e Lëvizjes së Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe? Nëse është ashtu, cili lloj i intervenimit nevojitet?

Analizoni informacionet vazhdimisht gjatë vlerësimit. Mos e leni analizën deri në fund të vlerësimit. Përjashtimi i thjeshtë nga kjo rregull ka të bëjë me analizën e informacioneve sektoriale. Nëse në ekipë nuk ka specialistë, informacionet lidhur me sektor të caktuar specifik duhet të analizohen kur kjo do të jetë e mundshme nga ana specialistit relevant pasi që vlerësimi të jetë gati.

Kur të arrijë tek dizajnimi i projektit në fushë të caktuar specifike, nevojiten konsultime me specialistë nga kjo pjesë.

Në këtë pjesë janë paraqitur këshilla në bazë të:

- Zgjedhje të mangësive që paraqiten në informacionet e grumbulluara;
- Mbledhja e informacioneve;
- Sintetizimi i informacioneve nga burime të ndryshme me qëllim që të arrihen konkluza;
- Përgatitja e rekomandimeve për në të ardhmen;
- Përgatitja e raportit nga vlerësimi.

### 8.1.1 Informacione të ndryshueshme

Tek secili vlerësim, do të ballafaqoheni me informacione të ndryshueshme. Kjo ndodh si rezultat i asaj që informatorët sigurojnë marrëveshje të ndryshme në pyetje të njëjta.

Për shembull:

- Një njeri thotë se burimi i ujit është i thatë dy muaj gjatë vitit përderisa tjetri thotë se burimi asnjëherë nuk shterret.
- Një njeri thotë se kafshët e fshatit kanë ngordhur e tjetri thotë se janë gjallë dhe kullosin në vende tjera.

Ekzistojnë masa të caktuara të cilat mund t'i ndërmerrni që t'i ulni apo zgjidhni këto mangësi. E para është mendoni për informacionet përderisa i grumbulloni. Kjo do t'ju ndihmojë të vëreni mangësi. Parashtroni pyetjet në vijim:

- A i prkrahin informacionet e reja apo janë në kundërshtim me informacionet sekondare?
- A janë të ngjajshme informacionet e grumbulluara nga një informator apo janë në kundërshtim me informacionet e informatorit tjetër?
- A janë të besueshme informacionet e grumbulluara nga anëtarët e ndryshëm të ekipit?
- Ka "kanë kuptim" informacionet? Për shembull, nëse dikush thotë se kontributi ka qenë zero, e ju shihni misër të freskët të mbledhur në fshat, këtu ekziston mosbesim.

Nëse i parashtroni këto pyetje do t'ju ndihmojë gjatë parashtrimit të pyetjeve të reja tek anëtarët e bashkësisë apo do të kërkoni burime alternative informative që ta qartësoni situatën. Vëzhgimi shpesh herë është i dobishëm gjatë situatave të tilla.

**Kujdes**

Si rregull e përgjithshme, mundohuni t'i verifikoni informacionet e rëndësishme nëpërmjet zbatimit të informacioneve të marrura nga dy deri në tre burime. Këto burime duhet të jenë të ndryshme sa më shumë që ka mundësi. Nëse disa

informacione të ndryshme u japin informacion të njëjtë, ai me siguri është i saktë. Ky proces quhet triangulacion.

Masa e dytë është të diskutohen udhëzimet në bazë të rregullsisë me anëtarët tjerë të ekipit.

- **Gjatë kohës së punës në teren.** Takohuni së paku një herë gjatë ditës që keni kaluar në teren (zakonisht diku rreth pasditës). Krahasoni informacionet, diskutoni rreth parregullsive dhe merruni vesh se a nevojiten modifikime të caktuara në bazë të orarit të intervistave.
- **Në fund të secilës ditë.** Pas secilës ditë të kaluar, diskutoni rreth informacioneve të grumbulluara dhe rreth konkluzave që keni nxjerrë.
- **Pas punës në teren.** Në fund të punës në teren, ekipi patjetër të mblidhet që të bisedojnë rreth konkluzave përfundimtare.

Masa e tretë është që të shqyrtohen arsyet për paraqitjen e mangësive. Ka tre mundësi kryesore në këtë plan:

- **Perceptimi.** Nuk ekziston gjithmonë përgjigje e “saktë”. Interpretimi i ngjarjeve nga ana e njerëzve varet nga rrethanat e tyre individuale.
- **Qasje në informacione.** Disa njerëz janë më mirë të informuar për temë të caktuar nga njerëz të tjerë.
- **Prezantim i gabuar.** Ndonjëherë njerëzit me qëllim japin informacione të gabuara.

Vendosni se a do të ndikojnë në konkluzat e vlerësimit dhe propozimet për programe të duhura në të ardhmen. Nëse luajnë rol të rëndësishëm në bazë të planifikimeve vijuese, mundohuni t’i zgjidhni por mos humbni shumë kohë në të. Nëse nuk mund t’i zgjidhni, shkruani vërejtje me sqarim në raportin përfundimtarë.

Nëse nuk ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në konkluzat përfundimtare, mundohuni t’i zgjidhni nëpërmjet:

- Vendosni se cila prej tre arsyeve të lartëpërmendura (apo kombinime të arsyeve) është relevante;
- Mendohuni pse informacionet dallohen;
- Shihni se në cilin burim mund të besoni (secili prej burimeve është më i besueshëm se tjetri);
- Kontrolloni informacionet – apo bisedoni përsëri me informatorët apo gjeni persona të ri të cilët mund t’ua sqarojnë informacionet.

Nëse këto masa nuk i zgjedhin parregullsitë, ju vetë duhet të vendosni. Në këtë rast, lideri i ekipit vendos se cila do të jetë konlkuza, në bazë të diskutimeve në ekipë edhe pas shqyrtimit të informacioneve të kapshme. Me rënëdësi është:

- Konkluzat të cilat bazohen në vendosje të theksohen qartë si në raportin për vlerësim, së bashku me detaje për propozimet e bëra që të nxjerren konkluzat konkrete.
- Të jepen rekomandime për procedurën e konkluzave.

### 8.2 Mbledhja e informacioneve

Informacionet do të mblidhen nga burime të ndryshme. Që të shfrytëzhen, ato duhet të mblidhen. Në këtë pjesë jepen kahje për mbledhjen e informacioneve nga intervistat e shumëllojshme.
Informacionet patjetër duhet të mblidhen në drejtim të informacioneve gjenerale kah informacionet specifike. Mund të përcillet klasifikimi si në vijim:

1. Informacionet sekondare do të përdoren që të përshkruhet situata/problemi/arsya globale se pse është bërë vlerësimi. Në raport kyçni të gjitha informacionet relevante të cilat janë të kontrolluara.
2. Intervistat në grupe dhe ato individuale me informatorë kyç do të sigurojnë informacione të përgjithshme për mirëqenien dhe situatën e përgjithshme në pjesën e vizituar. Mblidhni informacionet në formë sa më të shkrutë që mundet.
3. Intervistat në shtëpi do t'ju sigurojnë informacione më specifike për mirëqenien e njerëzve dh identifikimit të njerëzve sipas situatës së tyre të pasurisë (të varfër, të mesëm dhe të pasur). Për çdo lokacion të vizituar, mblidhni gjendjet nëpër shtëpitë të cilat do t'i vizitoni. Notoni ndryshimet dhe trendet. Nëse ka dallime të mëdhames familjeve në kuadër të lokacionit të njëjtë, siguroni informacione të posaçmepër secilin lloj të familjeve.

**Shembuj të aspkteve të cilat duhet të kyçen në rezime**

**Që gjërat të kuptohen më gjërësisht**

| | |
|---|---|
| Lokacioni | |
| Numri aproksimativ i individëve apo familjeve (theksoni) | |
| A është viti i keq, i mirë apo normal? | |
| Nëse viti është i keq, cilat janë shkaqet kryesore? | |
| Burime kryesore të të hyrave në vitin normal | |
| Efekti i situatës urgjente të burimeve të të hyrave për vlerësim të shpejtë dhe detal apo për efektin nga intervenimi i burimeve të të hyrave për vlerësim të vazhdueshëm. | |
| Detaje për strategji për menaxhim | |
| Strategjitë për menaxhim a kanë efekte negative afatshkurte apo afatgjate? | |
| A janë të mjaftueshme të hyrat momentale për të mbuluar të gjitha nevojat? | |
| Gjëra tjera të rëndësishme | |

### Që gjërat të kuptohen më mirë

| | |
|---|---|
| Lokacioni | |
| Numri i familjeve të vizituara | |
| Numri aproksimativ i familjeve të këtij tipi të lokacionit | |
| Gjendja e shtëpive (e kënaqshme, e pakënaqshme, e papranumeshme). Jepni detaje të shkurta nëse gjendja është e pakënaqshme apo e papranueshme. | |
| Dieta (burimi kryesor i ushqimit dhe ndryshime në normalen). | |
| Përdorimi i ujit (sasi adekuate, renditje etj). | |
| Gjendja shëndetësore (sëmundje dhe qasje në kujdes shëndetësor). | |
| Shitja e pasurisë. A e shesin njerëzit pasurinë? Nëse përgjigja është e vërtetuar, kush shet? | |
| Role dhe përgjegjësi të grave<br>Si ndryshohen? | |
| Jeta, stili i fëmijëve? Si ndryshohen? | |
| Madhësia dhe përbërja e familjeve (numri mesatar i burrave, grave dhe fëmijëve). | |
| Gjëra tjera të rëndësishme. | |

## 8.3 Mbledhja e informacioneve

Kjo pjesë e përshkruan procesin tre-hapësh për mbledhjen e informacioneve të burimeve të ndryshme dhe prezantimin e konkluzave në formatin i cili ëështgtë i dobishëm për planifikuesite programit. Secili hap është i paraqitur në tabelë me shënime të cilat sqarojnë se si të plotësohen tabelat. Ky proces bazohet në kuadër të mjerueshmërisë dhe kapaciteteve.

### 8.3.1 Hapi 1

| Problem | Normal apo i ri? | Nëse është normal, sa shpesh paraqitet problemi | Nëse është i ri, kur ka filluar problemi |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Rangimi i problemeve: A dakordohen të gjithë informatorët në bazë të rangimit të problemeve? Nëse jo, jepni detaje (cilat probleme paraqiten si më serioze nga secili grup i informatorëve).

Shënime tjera në bazë të informacioneve në tabelë:

**Vëerejtje:**

Numëroni të gjitha problemet e identifikuara gjatë vlerësimit. Bëhuni specifik. Mos thuani vetëm se problemi janë “vërshimet”. Thuani se problemet të cilat janë të shkaktuara nga vërshimet janë, për shembull:

- Jetë të humbura;
- Lëndime;
- Shtëpi të rrënuara;
- Kontaminimi i ujit për pije;
- Tjera.

Numëroni të gjithë këto gjëra si probleme më vete në tabelë. Rangoni problemet me renditje adekuate të rëndësisë (fillimisht të paraqitet problemi më i madh me pasoja më të mëdha). Shihni çdo problem a është “normal” apo “i ri”. Problemi normal është ai problem që ndodh për çdo vit (p.sh. “periudha e mungesës së ushqimit” para korrjes). Problem i ri mund të jetë problem i cili paraqitet si rezultat i situatës urgjente momentale (p.sh. kontaminimi i sistemit për furnizim me ujë pas vërshimeve në rajon).

Për probleme “normale”, shihni se sa shpesh ndodhin (p.sh. një herë në vit apo në herë në tre vjet). Për probleme “të reja”, shihni se kur kanë filluar problemet (sipas mundësisë me datë).

## 8.3.2 Hapi 2

| Problemi | Popullata e goditur (përshkrim) | Nevoja | Strategji për menaxhim | Ndihmë e fituar nga të tjerët |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

*Lokacioni i popullatës së goditur.*

*A është ky vend i zakonshëm i tyre për jetesë? Nëse jo, pse janë shpërngulur? Kur ka ndodhur shpërngulja e tyre?*

*Si është qasja në lokacione? Jepni të dhëna në bazë të sfidave lidhur me stinët e vitit, infrastrukturën (rrugë, aeroporte etj.), gjendja e sigurisë dhe faktorët politik.*

*Ndonjëra prej strategjive për menaxhim a ka pasoja negative të mirëqenies momentale dhe/apo mirëqenies afatgjate të njerëzve?*

*A ka ndonjë njeri që nuk ka qasje në ndihma? Nëse është ashtu, pse?*

**Vërejtje**

Identifikoeni grupin e popullatës së goditur nga secili nga problemet e paraqitura në Hapi 1. Përshkruani secilin grup të popullatës. Për shembull: “njerëzit të cilët jetojnë afër lumit”; “banorët e fshatit x”; “anëtarët e klanit Y”; apo “fëmijë në fshatin Z”.

Llogaritni numrin e njerëzve në secilin grup të popullatës së goditur, në bazë të informacioneve të cilat janë të grumbulluara gjatë vlerësimit.

Shpesh herë është vështirë të llogariten numra, për shkak se informacionet e burimeve dallohen.

- Nëse llogaritjet e informatorëve të ndryshëm janë afër njëra me tjetrën, llogariteni mesataren. Për shembull, informatori A thotë se numri i njerëzve është rreth 500, informatori B thotë se numri i njerëzve është 550 dhe informatori C thotë se numri i njerëzve është 575. Numrin të cilin do ta përdorni në raportin përfundimtar është mesatarja e nxjerrur nga këto numra: (500 + 550 + 575)/3=540.
- Nëse llogaritjet e burimeve të ndryshme dallohen shumë, duhet të vendosni se cili burim është më i besueshëm. Për shembull, informatori X jep llogaritjen se numri i njerëzve është 500, informatori Z mendon se numri i njerëzve është 1.500 ndërsa informatori Z mendon se numri i njerëzve është 1.600. ju e dini se informatori X është më i besueshëm krahasuar me dy të tjerët. Prandaj, mund ta përdorni numrin 700 (apo 800 apo 900 apo mesatare tjetër varësisht nga supozimi juaj).

Llogaritjet janë mirë në kuadër të vlerësimit. Por nëse duhet të zbatohet intervenim, atëherë duhet të bëhen llogaritje më detale.

Sqaroni nevojat të cilat rezultojnë nga secili problem. Për shembull:

- Problemi 1: Pusi është shterrur. Njerëzit kanë nevojë për burim i cili do të sigurojë së paku 15 litra ujë për njeri në ditë në radius prej 500 metra nga shtëpia e tyre.
- Problemi 2: Njerëzit nuk kanë ushqim të mjaftueshëm. Kanë nevojë për 50% ushqim për tre muajt e ardhshëm.

Kur ka mundësi, kuantifikoni nevojat. Për shembull, secila familje ka nevojë për ndihmë për 75 kg drithëra plotësuese në bazë mujore.

Përshkruani strategjitë ekzistuese për menaxhim lidhur me secilin problem të popullatës së goditur.

Për shembull:

- Problemi: pusi është shterrur.
- Popullata e goditur: fshati X.
- Strategjia për menaxhim 1: gratë dhe fëmijët hecin në këmbë nga tre orë deri tek burimi alternativ për ujë.
- Strategjia për menaxhim 2: njerëzit të lahen më rrallë.
- Strategji tjera për menaxhim.

Përshkruani ndihmën të cilën njerëzit e marrin për momentin. Ndihma mund të vjen nga vetë bashkësia apo nga jashtë. Mund të vjen nga sistemet tradicionale apo nga sistemet e zbatuara posaçërisht për këtë problem.

Për shembul:

- Sisteme tradicionale: grupet fetare në bashkësi zakonisht sigurojnë ndihmë për të varfërit.
- Sisteme specifike: ndihmë siguron agjencioni ndërkomëbtarë i cili është i pranishëm të përgjigjet në gjendjen momentale urgjente.

### 8.3.3 Hapi 3

| Popullata e goditur (përshkrim) | Nevoja | A i mbulojnë nevojat strategjitë për menaxhim dhe ndihmat | Përqindja e nevojave të mbuluara me strategji për menaxhim (A) | Përqindje të nevojave të mbuluara me ndihmë (B) | Mungesë në përqindje në mbulimin e nevojave (100-A-B) |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

*Sqaroni se si është llogaritur përqindja.*

**Vërejtje**

Për secilin grup të popullatës së goditur, numëroni nevojat të cilat janë të identifikuara në Hapin 2.

Theksoni se strategjitë ekzistuese dhe ndihma momentale a janë të mjafuteshme për mbulimin e nevojave (po ose jo).

Kur ka mundësi llogariteni shkallën e mbulimit të nevojave nëpërmjet strategjive për menaxhim dhendihmën. Për shembull:

- **Problem.** Shtëpi janë të rrënuara nga vërshimet.
- **Strategji për menaxhim.** Njerëzit blejnë material ndërtimor, përdorin material nga shtëpitë e rrënuara dhe marrin gjithashtu materiale nga farefisi apo nga miqtë. Nëpërmjet ushtrimit për grumbullim proporcional të informacioneve (shiko Pjesa 7.1.3), llogaritni se këto strategji mbulojnë rreth 65 përqind të nevojave. (A)
- **Ndihma.** Komuna ndan material të cakuar ndërtimor. Me këtë mbulohen 10 përqind e nevojave. (B)
- Nëpërmjet kombinimit të strategjive personale për menaxhim dhe përkrahja e komunës, njerëzit janë në gjendje të mbulojnë rreth 65+10=75 përqind të nevojave të tyre lidhur me materialin ndërtimor.
- here is a "gap" in needs coverage of 100–75 = 25 per cent of needs (100-A-B). This might be covered by the Red Cross Red Crescent.

## 8.4 Raporti i vlerësimit

Për çdo vlerësim, përgatitni raport të strukturuar sipas udhëzimeve të marrura nga shoqata nacionale / delegacioni. Vëllimin e posaçëm që do ta vendosni në çdo kaptinë të raportit do të varet nga rrethanat e secilit vlerësim.

Është shumë me rëndësi që konkluzat e vlerësimit të prezantohen në mënyrë sa më të qartë që mundet. Përdorimi i formateve standarde u ndihmon lexuesve që shpejtë të vijnë në informacionet e duhura.

**Vërejtje**

Raporti i vlerësimit duhet të jetë sa më i shkurtë, por keni kujdes të mos lëshoni informacione të rëndësishme.

Nga ekipi për vlerësim nuk pritet që të përgatisë propozim projekti. Megjithatë, idetë e ekipit janë shumë të dobishme për planifikuesit e programeve. Ka tre konkluza të mundshme nga vlerësimi (shiko Kornizën për mjerueshmëri dhe kapacitete, Pjesa 3);

- Nuk ka nevojë për intervenim (kapaciteti i popullatës së goditur është i mjaftueshëm që të ballafaqohet me problemin).
- Ka nevojë për intervenim, por Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe nuk është agjenci adekuate për zbatimin e këtij intervenimi.
- Ka nevojë për intervenim, dhe Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe është agjenci adekuate për zbatimin e këtij intervenimi.

Nëse vendosni se Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe duhet të intervenojë, jepni një rezime të shkurtë në formën në të cilën do të ishte intervenimi.

**Vërejtje**

Vlerësimi duhet të çojë kah përgatitja e propozim projektit konkret apo të mund të mbesë në formë të rekomandimit. Në rastin e dytë, do të duhet të grumbullohen informacione më të gjërësishme që të mund të përgatitet projekti.

### 8.4.1 Analiza dhe mjete për lajmërim

Ka mjete të caktuara të cilat mund t'ju ndihmojnë në analizën dhe lajmërimin për informacione të rëndësishme. Këto përkrahës vizuel në përgjithësi janë të lehta për lexim dhe kuptim se sa sqarimet e gjata tekstuale.

#### 8.4.1.1 Diagrami i interaksioneve

Diagrami i interaksioneve i tregon raportet (fuqinë dhe solidaritetin) mes një grupi të caktuar të njerëzve dhe participuesve të tjerë. Mundeni drejtëpërsëdrejti ta bëni diagramin me njerëzit të cilët i intervistoni apo fillimisht t'i grumbulloni informacionet dhe pastaj ta bëni diagramin. Kjo mund t'ju shërbejë si shtesë e shkëlqyeshme në raport.

Vendosni kategori të caktuar të njerëzve me interes në rreth në mjedis të diagramit. Pastaj shtoni rreth për secilin participient, të paraqitur dhe pozicionuar në madhësinë sipas rëndësisë/ndikimit të tij. Pastaj vizatoni shigjeta të cilat përgjigjen në llojin e raporteve. Paraqitja 15 jep shembull për diagramin e interaksioneve.

**Приказ 15**




**8.4.1.2 Analiza SWOT**

Ky mjet mundëson analizën e anëve të forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e një programi të caktuar. Matrica është e përbërë prej katër katrorëve, për secilën kategori të lartëpërmendur. Paraqitja 16 jep shembullin për Analizën SWOT të shpërndarjes së përgjithshme të ushqimit.

**Paraqitja 16 Matrica e analizës SWOT shembull për shpërndarje të përgjithshme të ushqimit**

| Anët e forta | Dobësitë |
|---|---|
